



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më __.__.2021

VENDIM
Nr. 150, datë 08.04.2021

PËR
MIRATIMIN E “RAPORT MBI VEPRIMTARINË E KOMISIONIT TË ZHVILLIMIT
TË KARRIERËS PËR VITIN 2020”

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në pikën 16, të nenit 62 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, me propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

V E N D O S I:

1. Miratimin e “Raport mbi veprimtarinë e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, për vitin 2020”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

KOMISIONI I ZHVILLIMIT TË KARRIERËS



RAPORT MBI VEPRIMTARINË E KOMISIONIT PËR VITIN 2020

TABELA E PËRMBAJTJES

I. HYRJE	3
II. MBI AKTET NËNLIGJORE	3
III. MBI PROCEDURAT E NGRITJES NË DETYRË	7
IV. MBI BASHKËPUNIMIN ME SHKOLLËN E MAGJISTRATURËS	31
V. MBI EMËRIMIN E MAGJISTRATËVE	35
VI. MBI SKEMËN E DELEGIMIT	40
VII. MBI KOMANDIMIN E GJYQTARËVE	41
VIII. MBI TRANSFERIMIN E GJYQTARËVE	42
IX. MBI MBARIMIN E STATUSIT TË MAGJISTRATIT	44
X. MBI CAKTIMIN NË POZICION TË GJYQTARËVE	45
XI. MBI CAKTIMIN E GJYQTARËVE NË ÇËSHTJE TË VEÇANTA	47
XII. MBI ÇËSHTJE TË TJERA	49
XIII. PËRFUNDIME	49
XIV. OBJEKTIVAT PËR VITIN 2021	51

I. HYRJJE

Komisioni i Zhvillimit të Karrierës përgjatë vitit 2020 ka përmbushur një sërë detyrash të rëndësishme që i përkasin fushës së veprimtarisë së tij, por edhe një sërë detyrash që lidhen me prioritetet e veprimtarisë së Këshillit të Lartë Gjyqësor (*në vijim referuar si Këshilli*).

Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (*në vijim referuar si KZHK ose Komisioni*) ka pasur në fokus ndjekjen e procesit të plotësimit të vendeve vakante në gjykata përmes skemës së delegimit, transferimit përkohësisht të gjyqtarëve, ngritjes në detyrë të gjyqtarëve, si dhe ka shqyrtuar kërkesat e paraqitura nga drejtuesit e gjykatave në lidhje me delegimin e gjyqtarëve të ndryshëm për shqyrtimin e çështjeve të caktuara. Gjithashtu, Komisioni ka shqyrtuar kërkesat e Shkollës së Magjistraturës për numrin e magjistratëve të rinj, emërimin dhe caktimin në pozicion të kandidatëve të diplomuar.

Pasur parasysh, Synimin 1 të Strategjisë së Këshillit të Lartë Gjyqësor, Komisioni pati prioritet përmbylljen sa më shpejt të kuadrit ligjor për ngritjen në detyrë të gjyqtarëve dhe në këtë mënyrë hapi procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve për 11 (*njëmbëdhjetë*) pozicione të lira në të tri fushat e së drejtës, administrative, civile dhe penale. Në këtë mënyrë, Këshilli iu përgjigj edhe Rekomandimit nr. 1 të Rezolutës së Kuvendit për KLGJ-në, për vitin 2020. Gjithashtu, prioritet ka qenë edhe plotësimi i pozicioneve të lira pranë gjykatave të posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar por për shkak të mungesës së kandidatëve për ngritjen në detyrë pranë këtyre gjykatave, Këshilli ka bërë thirrje disa herë për kandidime të cilat kanë rezultuar të pasuksesshme.

Përveç sa sipër, në kushtet kur nëpër gjykatat e të gjitha niveleve vijon boshatisja për shkak të efekteve të procesit të rivlerësimit kalimtar, si dhe ekzistojnë pengesa të ndryshme për plotësimin e tyre me gjyqtarë, Komisionit i është dashur të delegojë një numër të lartë gjyqtarësh, me qëllim zhblokimin e situatës dhe garantimin e dhënies së drejtësisë për individët.

II. MBI AKTET NËNLIGJORE

Ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (*në vijim referuar si Ligji për Statusin*) i ka deleguar Këshillit të drejtën që të miratojë një sërë aktesh të rëndësishme nënligjore, duke përfshirë edhe akte që lidhen me karrierën e gjyqtarit. Komisioni gjatë vitit 2020 ka hartuar dhe propozuar miratimin e tre akte nënligjore që i kanë hapur rrugë procedurave të ngritjes në detyrë të gjyqtarëve (*procedura këto që po realizohen po nga KZHK-ja*), procedurave të lëvizjes paralele të gjyqtarëve, si dhe procedurave

të verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të rekrutimit të kandidatëve për kancelar, për këshilltar ose ndihmës ligjor (*procedura këto që po realizohen nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit*). Po ashtu, gjatë këtij viti, Komisioni ka hartuar dhe propozuar miratimin e një shtese akti nënligjor, pikërisht të vendimit të tij nr. 30, datë 14.02.2019, në lidhje me caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta pranë gjykatave të posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar, duke i dhënë kështu zgjidhje nevojave emergjente të paraqitura në këto gjykata për çështje gjyqësore të ndryshme.

Aktet nënligjore të hartuara dhe propozuara për miratim nga KZHK-ja janë:

- 1) ***Vendimi nr. 70, datë 07.02.2020 “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”;***
 - 2) ***Vendimi nr. 320, datë 17.09.2020 “Për kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve”;***
 - 3) ***Vendimi nr. 424, datë 12.10.2020 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të rekrutimit të kandidatëve për kancelar, për këshilltar ose ndihmës ligjor”;***
 - 4) ***Vendimi nr. 126, datë 06.03.2020 “Për disa shtesa në Vendimin nr. 30, datë 14.02.2019”.***
- ***Vendimi nr. 70, datë 07.02.2020 “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”***

Në përmbushje të përgjegjësive për mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor, në respektim të parimit qeverisës të efikasitetit dhe në ushtrim të kompetencave në lidhje me administrimin e sistemit gjyqësor¹, Këshilli ka miratuar rregulla të detajuara, të cilat përcaktojnë rregulla për kriteret dhe procedurën që zbaton Këshilli për renditjen e gjyqtarëve që kandidojnë për ngritjen në detyrë. Ishte pikërisht puna në grup e drejtuar nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, i cili hartoi projektvendimin “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”, që i hapi rrugë ngritjes në detyrë të gjyqtarëve. Miratimi i këtij vendimi, është mbështetur në nenin 48 pika 14 e Ligjit për Statusin, i cili përcakton shprehimisht se Këshilli i Lartë Gjyqësor miraton rregulla më të detajuara, të cilat përcaktojnë:

- a) *kriteret për etikën dhe veprimtarinë profesionale ndërmjet kandidatëve me pikë të barabarta vlerësimi;*
- b) *kriteret për vlerësimin e përvojës profesionale që kërkohet për pozicionin e lirë;*
- c) *procedurën që ndiqet në rastin e pikëve të barabarta;*
- d) *zbatimin dhe përshtatjen e parashikimeve të këtij neni për pozicionet e lira të përkohshme.*

¹ Ky akt nënligjor ka dalë bazuar në nenin 147/a, pika 1, shkronja “a”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenin 48, pikat 9 dhe 14, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Gjithashtu, ky vendim është hartuar edhe në zbatim të vendimit nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, i cili në Kreun X, Seksioni Ç ka përcaktuar se procedura e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve rregullohet me akt te veçantë të Këshillit. Ky vendim, rregullon vetëm procedurën për renditjen e kandidatëve për ngritjen në detyrë, pasi procedura e vlerësimit dhe pikëzimit për ata është rregulluar me akte të tjera.

Miratimi i këtij akti nënligjor i ka hapur rrugë procedurave për ngritjen në detyrë të gjyqtarëve, në Gjykatën e Lartë, në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm, Gjykatën Administrative të Apelit si dhe në gjykatat e posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar, procedura këto që janë në proces.

➤ **Vendimi nr. 320, datë 17.09.2020 “Për kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve”**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 147/a, pika 1, shkronja “a”², të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet 42 dhe 43 të Ligjit për Statusin duke qenë përgjegjës për transferimin e gjyqtarëve, ka miratuar rregulla më të detajuara, të cilat përcaktojnë rregulla për kriteret dhe procedurën që zbaton Këshilli i Lartë Gjyqësor për renditjen e gjyqtarëve që kandidojnë për lëvizjen paralele, që është një nga mekanizmat e institutit juridik të transferimit të gjyqtarëve.

KZHK-ja hartoi dhe i propozoi Këshillit miratimin e projektvendimit “Mbi kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele”, i cili i hap rrugë lëvizjes paralele të gjyqtarëve. Miratimi i këtij vendimi, është mbështetur në nenin 43, pika 12 të Ligjit për Statusin, i cili përcakton shprehimisht se Këshilli i Lartë Gjyqësor miraton rregulla më të detajuara, të cilat përcaktojnë:

- a) *kriteret për vlerësimin etik dhe profesional ndërmjet magistratëve me pikë të barabarta vlerësimi;*
- b) *kriteret për vlerësimin e përvojës profesionale që kërkohet për pozicionin e lirë;*
- c) *procedurën që ndiqet në rastin e pikëve të barabarta;*
- d) *zbatimin dhe përshtatjen e këtij neni për pozicionet e lira të përkohshme.*

Vendimi rregullon vetëm kriteret dhe procedurën për renditjen e kandidatëve për lëvizjen paralele, pasi siç u sipër citua procedura e vlerësimit dhe pikëzimit për gjyqtarët është rregulluar me akte të tjera.

² Neni 147/a, pika 1, shkronja “a”, i Kushtetutës parashikon se: “1. Këshilli i Lartë Gjyqësor ushtron funksionet e mëposhtme: a) emëron, vlerëson, ngre në detyrë dhe transferon gjyqtarët e të gjitha niveleve;...”.

➤ **Vendimi nr. 424, datë 12.10.2020 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të rekrutimit të kandidatëve për kancelar, për këshilltar ose ndihmës ligjor”**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në përmbushje të përgjegjësive për drejtimin dhe kujdesjen për mbarëvajtjen e punës në administratën e gjykatave, bazuar në nenin 147/a, pika 1, shkronja “d”³, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neneve 53, 55 dhe 83, të Ligjit nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 165, të Ligjit për Statusin, si dhe nenit 6 të Ligjit nr.95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, duke qenë përgjegjës për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të rekrutimit të kandidatit për kancelar, për këshilltar ligjor ose për ndihmës ligjor, miratoi rregulla më të detajuara, të cilat përcaktojnë rregulla për procedurën që zbaton Këshilli i Lartë Gjyqësor për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të rekrutimit të kandidatit për kancelar, për këshilltar ligjor ose për ndihmës ligjor.

KZHK-ja hartoi dhe propozoi miratimin e projektvendimit “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të rekrutimit të kandidatit për kancelar, për këshilltar ose për ndihmës ligjor”, i cili i hapi rrugë verifikimit të kancelarëve në detyrë, këshilltarëve ligjorë në detyrë në Gjykatën e Lartë, ndihmës ligjorë në detyrë në gjykatat administrative, verifikimit të kandidatëve për këshilltarë ligjorë në Gjykatën e Lartë dhe për ndihmës ligjorë në gjykatat e apelit që kanë përfunduar programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, në vitin akademik 2019-2020, si dhe verifikimit të kandidatëve për këshilltarë ligjorë në Gjykatën e Lartë dhe për ndihmës ligjorë në gjykatat e apelit, të pranuar në programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2020-2021.

Duhet nënvizuar fakti se hartimi i të tre projektvendimeve të sipërcituara ka ardhur si rezultat i komunikimeve të vazhdueshme nga takimet e mbajtura me misionet partnere kryesisht EURALIUS dhe USAID, të cilët kanë dhënë një kontribut në këtë drejtim. Ndërkohë, miratimi i dy akteve të para që lidhen me karrierën gjyqësore është finalizuar pasi projektvendimet më parë i janë përcjellë për mendim trupës gjyqësore, si grup i interesuar drejtpërdrejtë nga zbatimi i këtyre dy vendimeve. Sugjerimet dhe mendimet e dhëna nga trupa gjyqësore janë reflektuar edhe në përmbajtjen përfundimtare të këtyre dy vendimeve.

➤ **Vendimi nr. 126, datë 06.03.2020 “Për disa shtesa në Vendimin nr. 30, datë 14.02.2019”**

Nisur nga volumi i madh i kërkesave të ardhura pranë KLGJ-së, nga gjykatat e shkallës së parë dhe të dytë, të cilat kërkonin delegim gjyqtarësh për plotësimin e trupave gjyqësore, Komisioni në vitin 2019 hartoi dhe i propozoi KLGJ-së projektvendimin “Për rregullat dhe procedurat për caktimin e gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të

³ Neni 147/a, pika 1, shkronja “d”, i Kushtetutës parashikon se: “1. Këshilli i Lartë Gjyqësor ushtron funksionet e mëposhtme: ... d) drejton dhe kujdeset për mbarëvajtjen e punës në administratën e gjykatave, me përjashtim të mbarëvajtjes së strukturave të teknologjisë së informacionit në gjykata, e cila rregullohet me vendim të Këshillit të Ministrave;..”.

ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, miratuar me vendimin nr. 30, datë 14.02.2019 (*i ndryshuar*), mekanizëm ky që i dha zgjidhje situatës dhe me të cilën KLGJ-ja operoi edhe përgjatë vitit 2020.

Përgjatë vitit 2020, Komisioni ka propozuar disa shtesa për këtë akt nënligjor, të cilat janë miratuar me Vendimin e Këshillit nr. 126, datë 06.03.2020. Me shtesat e bëra u synua zgjidhja e nevojave në vijim, në çështje gjyqësore të veçanta, në gjykatat e posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar, meqenëse në Vendimin e Këshillit nr. 30, datë 14.02.2019, nuk kishte rregullime për gjykatat e posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar, nisur nga vetë koha e miratimit të aktit, në raport me momentin e fillimit të funksionimit të këtyre gjykatave.

Situata e vështirë pranë këtyre gjykatave lidhej me faktin se, në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ushtronin detyrën 11 gjyqtarë, 2 të caktuar në mënyrë të përhershme dhe 9 të tjerë në mënyrë të përkohshme, në pritje të përfundimit të procesit të rivlerësimit kalimtar për ata, ndërsa në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ushtronin detyrën 6 gjyqtarë, 5 të caktuar në mënyrë të përhershme dhe 1 në mënyrë të përkohshme, në pritje të përfundimit të procesit të rivlerësimit. Ndërkohë, Këshilli, më datë 26.02.2020 shpalli procedurat e ngritjes në detyrë pranë këtyre gjykatave, për 5 pozicione të lira në secilën gjykatë dhe procedurat e ngritjes ishte e kuptueshme që do të kërkonin kohë për përfundimin e tyre.

Miratimi i këtij akti i hapi rrugë caktimit të gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta pranë gjykatave të posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar duke i dhënë kështu zgjidhje kërkesave të paraqitura nga këto gjykata për caktim gjyqtarësh për çështje gjyqësore të veçanta.

III. MBI PROCEDURAT E NGRITJES NË DETYRË

1. PËR GJYKATËN E LARTË

1.1 Procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur

Referuar Synimit 1 të Planit Strategjik të Këshillit të Lartë Gjyqësor për Sistemin Gjyqësor të Republikës së Shqipërisë, prioritet emergjent është bërja funksionale e Gjykatës së Lartë⁴. Rifunksionalizimi i Gjykatës së Lartë u kthye në një domosdoshmëri dhe prioritet në veprimtarinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor, duke miratuar aktet nënligjore⁵ që i hapën më pas rrugë procedurës së përzgjedhjes për emërim të anëtarëve në Gjykatën e Lartë, nga radhët e

⁴ Pika 1.1 e Synimit 1 e Planit Strategjik të Këshillit të Lartë Gjyqësor për Sistemin Gjyqësor të Republikës së Shqipërisë, prioritet emergjent është bërja funksionale e Gjykatës së Lartë (faqe 12).

⁵ Vendimi nr. 75, datë 23.5.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për avancimin e karrierës së gjyqtarëve dhe emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”; Vendimi nr. 102, datë 05.07.2019, “Mbi kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jo-gjyqtarë dhe procedurën e përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë”; Vendimi nr. 209, datë 11.10.2019, “Metodologjia për vlerësimin dhe pikëzimin e kandidatëve jo-gjyqtarë për në Gjykatën e Lartë”.

juristëve të spikatur. KLGJ-ja nëpërmjet vendimeve nr. 108, nr. 109 dhe nr. 110, datë 09.07.2019 dhe nr. 172, datë 11.09.2019, mbi propozimet e KZHK-së, shpalli hapjen e procedurave të emërimit në Gjykatën e Lartë dhe bërjen e thirrjes për paraqitjen e kandidaturave, nga radhët e juristëve të spikatur, për 4 pozicione të lira, që plotësojnë kërkesat specifike për ekspertizë të veçantë në tre fushat e së drejtës administrative, civile dhe penale.

Pas realizimit të procesit të verifikimit të 23 kandidatëve dhe kualifikimit, vetëm të 3 prej tyre për 3 pozicionet e para të lira në Gjykatën e Lartë, Komisioni i ka propozuar KLGJ-së miratimin e 4 akteve⁶ për fillimin e procedurës së përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë të kandidatëve, nga radhët e juristëve të spikatur. Ndërkohë, për pozicionin e katërt të shpallur, gjatë 2019 nuk pati kandidatë të kualifikuar, por megjithatë, me Vendimin nr. 262, datë 13.11.2019, Këshilli ka miratuar propozimin e Komisionit, që për shkak të angazhimeve që kishte, në procedurat e shortit, për caktimin e anëtarëve relatorë që do të ndjekin procedurat e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për këtë pozicion të lirë, të përfshihej edhe anëtari zëvendësues i Komisionit, z. Dritan Hallunaj.

Gjatë vitit 2020, për shkak të tërheqjes së një kandidati nga pozicioni i lirë në fushën e të drejtës administrative, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 108, datë 09.07.2019⁷, KZHK-ja ka propozuar miratimin e vendimit për përfundimin e procedurës së përzgjedhjes në Gjykatën e Lartë për këtë kandidat, për pozicionin e lirë në fjalë. Në këtë mënyrë, në tre pozicionet e para të lira, gjatë procedurës së përzgjedhjes për emërim, mbeti nga një kandidat për secilin pozicion të lirë.

Pas kryerjes së veprimeve procedurale dhe verifikuese të relatorit përkatës, sipas përcaktimeve të bëra në Vendimin nr. 102, datë 05.07.2019, “Mbi kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jogjyqtarë dhe procedurën e përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë”, u miratuan vlerësimet dhe pikëzimet paraprake të kandidatëve më të mirë që konkurrojnë për në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, në secilën fushë të së drejtës, me Vendimet e Këshillit nr. 101, nr. 102 dhe nr. 103, datë 26.02.2020. Më pas, me Vendimet e Këshillit nr. 104, nr. 105 dhe nr. 106, datë 27.02.2020, u miratuan vlerësimet dhe pikëzimet përfundimtare për secilin kandidat. Më tej procedurat për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, vijoi me miratimin nga Këshilli të Vendimeve nr. 107, nr. 108 dhe nr. 109, datë 27.02.2020, për renditjen e kandidatëve që konkurrojnë për në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, për secilin pozicion të lirë. Pas kësaj, procedura e përzgjedhjes së gjyqtarëve për në Gjykatën e Lartë, u finalizua me miratimin nga Këshilli të Vendimeve nr. 110⁸, nr. 111⁹ dhe nr. 112¹⁰, datë 27.02.2020, me anë të të cilëve u propozua emërimi në Gjykatën e

⁶ Vendimet nr. 259, nr. 260, nr. 261 dhe nr. 262, datë 13.11.2019.

⁷ Ky vendim i përket kandidatit Ervin Pupe.

⁸ Vendimi nr. 110, datë 27.02.2020 “Për propozimin për emërim në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, të kandidatit z. Sokol Sadushaj”.

⁹ Vendimi nr. 111, datë 27.02.2020 “Për propozimin për emërim në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, të kandidatit z. Ervin Pupe”.

¹⁰ Vendimi nr. 112, datë 27.02.2020 “Për propozimin për emërim në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, të kandidatit z. Ilir Panda”.

Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, për tre kandidatët e renditur më lart. Në përfundim, Presidenti i Republikës së Shqipërisë, me anë të Dekreteve nr. 11452, 11453 dhe 11454, datë 11.03.2020, emëroi tre kandidatët e propozuar nga Këshilli, si gjyqtarë të Gjykatës së Lartë.

Ndërkohë, në lidhje me kandidatin e vetëm që mbeti, i cili ka kandiduar për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr. 172, datë 11.09.2019, gjatë procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit, pas miratimit të dorëheqjes së relatorit, me Vendimin nr. 353, datë 24.09.2020, u caktua si relator një nga anëtarët e tjerë të përhershëm të KZHK-së. Në përfundim të procedurës për verifikimin e kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit për këtë kandidat, Këshilli miratoi Vendimin nr.560, datë 13.11.2020, për kualifikimin e kandidatit dhe vijimin e procedurës së përzgjedhjes për emërim si gjyqtar në Gjykatën e Lartë. Pas kësaj vendimmarrje të Këshillit, është në proces procedura e vlerësimit etik dhe profesional dhe, me tej, ajo e përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë.

Përfundime në lidhje me procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur gjatë vitit 2020, ku rezulton se janë miratuar:

- **16 (gjashtëmbëdhjetë) vendime/akte administrative individuale** që i përkasin procedurave për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, të cilat u finalizuan me dekretimin nga Presidenti i Republikës së tre kandidatëve të propozuar nga Këshilli, si gjyqtarë të Gjykatës së Lartë, ndërsa një kandidat i kualifikuar vijon konkurrimin për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile.

1.2 Procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, para miratimit të Rezolutës për KLGJ-në nga Kuvendi

Këshilli, pas plotësimit të kuadrit ligjor nëpërmjet miratimit të akteve nënligjore të autorizuara nga ligji¹¹, në ushtrim të përgjegjësisë për mbarëvajtjen e sistemit gjyqësor (neni 147, pika 1, i Kushtetutës) dhe në veçanti të funksionit të ngritjes në detyrë të gjyqtarëve të të gjitha niveleve (neni 147/a, pika 1, shkronja “a”, i Kushtetutës), mbi propozimet e KZHK-së, me Vendimet nr. 82, nr. 83, nr. 84, nr. 85, nr. 86 dhe nr. 87, datë 26.02.2020, ka hapur procedurat për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, për gjashtë pozicione të lira, tre në fushën e të drejtës administrative dhe tre në fushën e të drejtës civile.

¹¹ Vendimi nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”;

Vendimi nr. 102, datë 05.07.2019, “Mbi kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jogjyqtarë dhe procedurën e përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë”;

Vendimi nr. 209, datë 11.10.2019, “Metodologjia e vlerësimit dhe pikëzimit të kandidatëve jogjyqtarë për në Gjykatën e Lartë”;

Vendimi nr. 263, datë 21.11.2019, “Për rregullat plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve”;

Vendimi nr.264, datë 21.11.2019, “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”;

Vendimi nr. 70, datë 07.02.2020, “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”.

Këshilli në këtë rast, mbajti parasysh qëllimin e tij strategjik për rikthimin sa më parë të funksionalitetit të plotë të Gjykatës së Lartë, por mori parasysh dhe vlerësoi edhe një sërë rrethanash të tjera, ku hapja njëherazi e procedurave për të gjitha vendet vakante pranë Gjykatës së Lartë mund të mbarte një sërë problematikash.

Secili vendim është i ndarë në katër krerë, ku në Kreun I përcaktohet hapja e procedurës dhe shpallja e thirrjes për kandidatura, në Kreun II përcaktohet afati i kandidimit, në Kreun II Informacioni dhe dokumentacioni që i bashkëlidhet kandidimit dhe në Kreun IV procedura e kandidimit. Secilit vendim i bashkëlidhen dy Vetëdeklarimet që duhet të plotësohen nga kandidatët, Vetëdeklarim “Për masa disiplinore” sipas nenit 48, pika 8 të Ligjit për Statusin dhe Vetëdeklarim “Për situatën e papajtueshmërisë ambientale” sipas nenit 8, pika 5 të Ligjit për Statusin.

Për shkak të gjendjes së krijuar nga Covid-19, Këshilli në datë 12.03.2020, pezulloi veprimtarinë e tij e për rrjedhojë edhe procedurat për ngritjen në detyrë të gjyqtarëve, të cilat rifilluan me Vendimin nr. 142, datë 22.04.2020 të Këshillit. Afatet e kandidimit për katër pozicionet e para të lira, nga dy në secilën fushë të së drejtës u zgjatën, ndërkohë që afatet e kandidimit për dy pozicionet e fundit, në secilën fushë të së drejtës, nuk u zgjatën por vijoi të mbetej i njëjti afat, ai pesë muaj, që përfundoi më datë 30.07.2020.

Në përfundim të afatit të kandidimit, për dy pozicionet e para të lira në secilën fushë të së drejtës, mbi propozimin e KZHK-së, Këshilli me Vendimin nr. 151, datë 06.05.2020, ka vendosur fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë. Për këto pozicione kandiduan gjithsej 11 (*njëmbëdhjetë*) kandidatë, 5 (*pesë*) prej të cilëve në të dyja fushat e së drejtës. Pas zhvillimit të shortit, u caktuan relatorët përkatës për të realizuar procedurën e verifikimit për secilin kandidat.

Pasi përfundoi edhe afati i kandidimit për dy pozicionet e dyta të lira, me Vendimin nr. 201, datë 11.06.2020, mbi propozimin e KZHK-së, Këshilli ka vendosur fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, edhe për këto pozicione të lira. Për dy pozicionet e dyta të lira në secilën fushë të së drejtës kandiduan gjithsej 10 (*dhjetë*) kandidatë, 9 (*nëntë*) prej të cilëve kishin aplikuar edhe për të dyja ose ndonjë nga pozicionet e para të lira. Pra, në këto pozicione pati vetëm një kandidat që kandidoi rishtazi, që nuk kishte kandiduar më parë. Pas zhvillimit të shortit, u caktua edhe relatori përkatës nga anëtarët e KZHK-së, për të realizuar procedurën e verifikimit vetëm për kandidatin që kishte kandiduar rishtazi, ndërkohë që kandidatët që kishin kandiduar edhe më parë, vijuan të verifikohen nga të njëjtët relatorë.

Ndërkohë, për t'i hapur rrugë kryerjes së vlerësimeve etike dhe profesionale të kandidatëve, si element kyç i përcaktuar nga ligji për ngritjen në detyrë të gjyqtarëve sipas meritokracisë, Këshilli ndau në dy pjesë procedurën e verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit. Në pjesën e parë, u verifikuan tre kriteret formale të kandidimit, pikërisht ai i “*përvojës profesionale*

*minimale*¹², i “*mospasjes masë disiplinore në fuqi*”¹³ dhe i “*mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale*”¹⁴. Pas verifikimit të plotësimit të tre prej kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, u vijua me procesin e vlerësimit etik dhe profesional, procese që janë duke u zhvilluar nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale. Ky proces vijoi paralelisht me procesin për verifikimin e kriterëve të pasurisë dhe figurës, proces që realizohet nga KZHK-ja.

Në lidhje me 12 (dymbëdhjetë) kandidatët që kandiduan për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, relatorët përkatës kanë realizuar procedurën e verifikimit të tre kriterëve formale të kandidimit, pikërisht atë të “*përvojës profesionale minimale*”, të “*mospasjes masë disiplinore në fuqi*” dhe të “*mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale*”. Në këtë mënyrë, mbi propozimet e relatorëve anëtarë të KZHK-së, Këshilli ka miratuar 12 (*dymbëdhjetë*) akte administrative individuale për verifikimin e plotësimit të tre kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, për të gjithë kandidatët që kandiduan për katër pozicionet e para të lira.

Ndërkohë, rezultoi që dy nga kandidatët që kandiduan në procedurat e ngritjes në detyrë nuk kishin kaluar ende procesin e rivlerësimit kalimtar, ndaj, për këta 2 (*dy*)¹⁵ kandidatë, me Shkresën nr. 2116 prot., datë 07.05.2020, Këshilli i ka kërkuar Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (*në vijim referuar si KPK*) trajtimin me përparësi të procedurës së rivlerësimit kalimtar për ata. Me Shkresën nr. 3716 prot., datë 26.05.2020, KPK-ja ka njoftuar Këshillin se çështjet e gjyqtarëve janë shpërndarë me short e janë në proces rivlerësi nga trupat gjykues dhe po trajtohen me përparësi.

Duhet theksuar se kërkesa për trajtimin me përparësi të procedurës së rivlerësimit kalimtar për 2 (*dy*) kandidatët është bërë sipas Vendimit të Këshillit nr. 75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, në të cilin përcaktohet se: “*Kandidatët që i nënshtrohen procedurës së rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr.84/2016 dhe janë në procedurë e sipër rivlerësi ose për të cilët kjo procedurë nuk ka filluar ende, nuk i nënshtrohen procedurës së verifikimit të pasurisë dhe të figurës nga Këshilli, sipas përcaktimeve të pikave 2 deri në 7, të nenit 32, të Ligjit për Statusin. Vendimi i Këshillit për*

¹² Neni 136, pika 3 (fjalja e parë), e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, përcakton se: “Gjyqtari i Gjykatës së Lartë zgjidhet nga radhët e gjyqtarëve me të paktën 13 vjet përvojë në ushtrimin e profesionit”. Neni 47, pika 5, e Ligjit për Statusin përcakton se: “Magjistrati mund të ngrihet në detyrë në pozicione pranë Gjykatës së Lartë ..., nëse ka ushtruar funksionin jo më pak se trembëdhjetë vjet në nivele më të ulëta, nga të cilat të paktën pesë vjet në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionin e lirë, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar”.

¹³ Neni 48, pika 8, e Ligjit për Statusin, përcakton se: “Vetëm kandidatët të cilët ... nuk kanë masa disiplinore në fuqi, pranohen në procedurat e mëtejshme të ngritjes në detyrë”.

¹⁴ Neni 8, pika 2, e Ligjit për Statusin, përcakton se: “Këshillat, gjatë ... ngritjes në detyrë të magjistratit, për aq sa është e mundur dhe pa cenuar në mënyrë joproporcionale të drejtën për zhvillimin normal të karrierës profesionale të magjistratit, marrin masa për të shmangur papajtueshmërinë ambientale, sipas pikës 3, të këtij neni, me qëllim që të garantohet besimi i publikut në sistemin e drejtësisë, pavarësia dhe paanësia e magjistratit, eficienta e gjykatave dhe zyrave të prokurorisë në dhënien e drejtësisë”.

¹⁵ Gjyqtarët Alma Hicka dhe Sokol Ngresi.

kualifikimin ose jo për këta kandidatë do të mbështetet në vendimin e dhënë nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit. Në këtë rast, Këshilli i kërkon Komisionit të Pavarur të Kualifikimit trajtimin me përparësi të procedurës së rivlerësimit për këta kandidatë. Nëse Komisioni i Pavarur i Kualifikimit nuk i përgjigjet kërkesës së Këshillit ose nuk përfundon procedurat e rivlerësimit për këta kandidatë brenda 3 muajve nga momenti i paraqitjes së kërkesës, këta kandidatë i nënshtrohen procedurës së verifikimit të pasurisë dhe të figurës sipas përcaktimeve të pikave 2 deri në 7, të nenit 32, të Ligjit për Statusin” (Kreu X, Seksioni B, pika 2).

Ky përcaktim në këtë akt nënligjor është bërë në funksion të shmangies së një kontrolli të dyfishtë për këtë kategori kandidatësh, duke konsideruar se kushtetutëbërësi ka konsideruar si të domosdoshëm dhe parësor rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve.

Po ashtu, ky përcaktim është bërë edhe me qëllim shmangien e përfundimeve të ndryshme mes organeve të rivlerësimit dhe Këshillit, çka do të sillte konfuzion në proceset respektive dhe më kryesorja cenim të besimit tek këto institucione kushtetuese. E përveç kësaj, ky përcaktim është bërë edhe për shmangien e situatës në lidhje me funksionalitetin e Gjykatës së Lartë në rastin e një gjyqtari të ngritur në detyrë, i cili më pas, me vendim të organeve të rivlerësimit, shkarkohet nga detyra. Deri në përfundim të procesit të rivlerësimit kalimtar me vendim përfundimtar, pozicioni i mbajtur nga ky gjyqtar nuk do të mund të plotësohej sa kohë sipas ligjit, në Gjykatën e Lartë, mund të plotësohet vetëm një pozicion i lirë në mënyrë të përhershme. Lidhur me këtë moment, vlen të përmendet Opinioni datë 19.06.2020, i Komisionit të Venecias, ku ndër të tjera është shprehur se: “83. Ky opinion përqendrohet në emërimet në Gjykatën Kushtetuese dhe Komisioni i Venecias nuk është i pajisur dhe nuk ka mandat të shqyrtojë këto pretendime. Sidoqoftë, për Komisionin është e qartë se procesi i vetting duhet të zhvillohet sa më shpejt që të jetë e mundur, por duke siguruar një shqyrtim të drejtë të secilit rast. Duhet të gjenden modalitetet e përshtatshme, dhe të ndryshohen nëse është e nevojshme, që ky proces të mos frenojë funksionimin e institucioneve gjyqësore të Shqipërisë. Komisioni s’mund të bëjë gjë tjetër veçse të rekomandojë përsheptimin dhe racionalizimin e procesit të vetting, që duhet kuptuar se vettingu në nivelin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit si dhe Kolegjit të Posaçëm të Apelimit do të duhet të vazhdojë të zbatohet në mënyrë koherente. Koherenca duhet gjithashtu të sigurohet edhe në procedurën e vetimit të kandidatëve nga jashtë gjyqësorit të kryera nga KED. Procesi nuk duhet të rezultojë në vazhdimin e paralizimit të institucioneve gjyqësore. 84. Në çdo rast, nuk mund të ketë asnjë dyshim se anëtarët e Gjykatës Kushtetuese duhet të kalojnë vetting dhe se KED duhet të propozojë vetëm kandidatë që kanë kaluar procedurën e vetting, me vendim përfundimtar”. Për analogji, mbetet të pranohet se edhe gjyqtarët e Gjykatës së Lartë duhet të kalojnë vetting dhe se Këshilli i Lartë Gjyqësor duhet të propozojë vetëm kandidatë që kanë kaluar procedurën e vetting-ut.

Po ashtu, kërkesa për trajtimin me përparësi të procedurës së rivlerësimit kalimtar për 2 (dy) kandidatët është bërë edhe duke patur në konsideratë Rregulloren e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, ku në nenin 3, pika 7, shkronja “b”, përcaktohet se: “7. Përveç shortit të organizuar sipas pikës 6 më sipër, Komisioni organizon short të veçantë dhe të posaçëm brenda 30 ditëve nga marrja

dijeni zyrtarisht për kandidimin, për: ...; b) Subjektet e rivlerësimit, të cilët, edhe pse nuk bëjnë pjesë në listën e përparësive për shkak të ligjit, kanë përparësi për shkak të statusit si kandidatë për t'u përzgjedhur në ..., institucionet e lidhura ..., të KLGJ-së, ...”.

Ndërsa, për gjyqtarët e tjerë kandidatë për në Gjykatën e Lartë, meqenëse ata kishin kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar, me vendim të formës së prerë, relatorët përkatës vijuan procedurën e verifikimit të kriterëve të pasurisë dhe figurës, për periudhën pasi ishin dhënë vendimet nga organet e rivlerësimit kalimtar.

Nga dy kandidatët e sipërcituar, rezulton se vetëm për një kandidat¹⁶ ka përfunduar procesi i rivlerësimit kalimtar, ndërsa ai është konfirmuar në detyrë, por se vendimi i KPK-së ende nuk ka marrë formë të prerë. Ndërsa për kandidatin¹⁷ tjetër Këshilli është në pritje të vendimmarrjes së KPK-së.

Ndërkohë, për 4 kandidatë që kishin kandiduar në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë për katër pozicionet e para të lira, për shkak të tërheqjes së tyre nga kandidimi për disa nga pozicionet e lira ku kishin kandiduar fillimisht, me propozim të Komisionit, Këshilli ka miratuar përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë për këta kandidatë, për pozicionet përkatëse¹⁸.

1.3 Procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, pas miratimit të Rezolutës për KLGJ-në nga Kuvendi

Përveç sa sipër, Këshilli, mbas diskutimeve në mbledhjet plenare të datave 02.07.2020 dhe 09.07.2020, me qëllim bërjen funksionale të Gjykatës së Lartë, si dhe me qëllim që kjo gjykatë të përmbushte detyrimet e tjera kushtetuese, mbi propozimet e KZHK-së, me Vendimet nr.241, nr.242, nr.243, nr.244 dhe nr.245, datë 09.07.2020, ka vendosur të hapë procedurat për ngritjen në detyrë pranë kësaj gjykate, edhe për 5 (pesë) pozicione të tjera të lira (4 pozicione në fushën e të drejtës penale dhe 1 pozicion në fushën e të drejtës administrative), duke e çuar në këtë mënyrë në 11 (njëmbëdhjetë) numrin e pozicioneve të lira pranë kësaj gjykate.

Në këtë rast, Këshilli ka vlerësuar se duke hapur procedurat e ngritjes në detyrë nga radhët e gjyqtarëve, në total për 11 (njëmbëdhjetë) pozicione të lira, duke llogaritur edhe tre pozicione të gjyqtarëve të emëruar, nga radhët e juristëve të spikatur, në muajin mars 2020, si dhe një pozicion tjetër të lirë, nga radhët e juristëve të spikatur, që është në proces, Gjykata e Lartë kthehej pothuaj në funksionalitet të plotë, mbasi arrinte kuoromet e nevojshme për shqyrtimet gjyqësore, sidomos ato të njësimit të praktikave gjyqësore nga Kolegjet e Bashkuara, si dhe përmbushjen e detyrës së kësaj gjykate, për zgjedhjen e tre anëtarë të Gjykatës Kushtetuese (Rekomandimi nr. 1 i Rezolutës së Kuvendit për KLGJ për vitin 2020).

¹⁶ Gjyqtari Sokol Ngresi.

¹⁷ Gjyqtaren Alma Hicka.

¹⁸ Vendimi nr. 192, datë 04.06.2020, që i përket kandidatit Gentian Medja, Vendimi nr. 261, datë 23.07.2020, që i përket kandidates Klodiana Veizi, Vendimi nr. 287, datë 08.09.2020, që i përket kandidates Albana Boksi dhe Vendimi nr. 290, datë 08.09.2020, që i përket kandidatit Klodian Kurushi.

Afati i kandidimit për 5 (*pesë*) pozicionet e lira të shpallura më datë 09.07.2020, u përcaktua deri më datë 30.07.2020.

Në përfundim të afatit të kandidimit për këto 5 (*pesë*) pozicione të lira, por edhe për 2 (*dy*) pozicionet e tjera të shpallura më datë 26.02.2020, pra deri më datë 30.07.2020, krahas disa gjyqtarëve që kishin kandiduar edhe më parë, kandiduan rishtazi edhe 11 (*njëmbëdhjetë*) gjyqtarë të tjerë.

Në këtë mënyrë, për 11 (*njëmbëdhjetë*) pozicione të lira në total, kandiduan gjithsej 23 (*njëzet e tre*) kandidatë dhe se shumica e kandidatëve ka shfrytëzuar të drejtën që iu jep ligji, neni 48, pika 6¹⁹, i Ligjit për Statusin duke kandiduar deri në tre pozicione të lira.

Në përfundim të afatit të kandidimit, mbi propozimin e KZHK-së, Këshilli me Vendimin nr. 268, datë 07.08.2020, ka filluar procedurën e verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për kandidatët nga radhët e gjyqtarëve që kanë aplikuar për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet nr.84 dhe nr.87, datë 26.02.2020 (*në fushat e të drejtës administrative dhe të së drejtës civile*), me Vendimet nr.241, nr.242, nr.243 dhe nr.244, datë 09.07.2020 (*në fushën e të drejtës penale*), si dhe me Vendimin nr.245, datë 09.07.2020 (*në fushën e të drejtës administrative*), të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Pas hedhjes së shortit u caktuan relatorët përkatës për të kryer procedurat e verifikimit.

Për kandidatët që kishin kandiduar më parë për pozicionet e lira në Gjykatën e Lartë, ose edhe për ngritjen në detyrë në gjykata të tjera, procedura të cilat vijonin të ishin ende në proces, u vendos që procedurat e verifikimit sa i përket pasurisë dhe figurës që ishin në proces e sipër për këto kandidime, do të ishin të vlefshme edhe për kandidimet e tyre për një ose disa nga pozicionet e lira në Gjykatën e Lartë, të shpallura me Vendimet e Këshillit nr.84 dhe nr.87, datë 26.02.2020, si dhe me Vendimet e tij nr.241, nr.242, nr.243, nr.244, dhe nr. 245, datë 09.07.2020.

Në këtë mënyrë, për 11 kandidatët që kishin kandiduar rishtazi në procedurat e ngritjes në detyrë, mbi propozimet e relatorëve anëtarë të KZHK-së, Këshilli ka miratuar 11 (*njëmbëdhjetë*) vendime për verifikimin e plotësimit të tre kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve. Ndërkohë, po mbi propozimet e relatorëve anëtarë të KTHK-së, Këshilli ka miratuar edhe 7 (*shtatë*) vendime për verifikimin e plotësimit të tre kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve edhe për kandidatët që kishin kandiduar më parë në procedurat e ngritjes në detyrë, meqenëse tashmë kandidonin në pozicione të tjera, disa në të njëjtën fushë të së drejtës, ndërsa disa në fusha të ndryshme të së drejtës.

¹⁹ Ky nen përcakton: "Pas shpalljes së procedurës së ngritjes në detyrë, kandidati mund të kandidojë për jo më shumë se tre pozicione të lira ose pozicione që priten të bëhen të lira. Nëse magjistrati kandidon për më shumë se një pozicion, ai bën renditjen e tyre sipas preferencës".

Nga 11 kandidatët që kandiduan rishtazi, në pozicionet e lira afati i të cilave përfundoi më datë 30.07.2020, për shkak se 4 (*katër*)²⁰ kandidatë nuk i ishin nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar, Këshilli mbi të njëjtat argumente sikurse më sipër është cituar, i ka kërkuar Komisionit të Pavarur të Kualifikimit që ti trajtonte me përparësi këta kandidatë.

Rezultoi që KPK-ja gjatë vitit 2020 ka disponuar me vendim vetëm për njërin nga kandidatët²¹, ndërsa për të tjerët ende vijon procesi i rivlerësimit kalimtar dhe nuk ka vendimmarrje nga ky institucion.

Nga kandidatët që kandiduan rishtazi për pozicionet e lira afati i të cilave përfundoi më datë 30.07.2020, dy²² nga kandidatet u tërhoqën nga kandidimi mbasi Këshilli kishte miratuar vendimet për verifikimin e plotësimit të tre kriterëve ligjore të kandidimit dhe kishte vijuar procesin e vlerësimit etik dhe profesional të tyre. Në këtë rast, Komisioni ka propozuar projektvendimet për përfundimin e procedurave të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, për secilin nga këta dy kandidatë të tërhequr nga kandidimi.

Në lidhje me procedurën e verifikimit të pasurisë dhe figurës së kandidatëve u hasën probleme me mosdërgimin e Informacionit nga Autoriteti për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, kjo për shkak të përcaktimit të bërë në pikën 2, të nenit 27, të Ligjit nr.45/2015 *“Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”*, sipas të cilit Autoriteti vë në dispozicion dokumentacion dhe lejon përdorimin e dokumenteve, për qëllime të verifikimit të zyrtarëve, në përputhje me kërkesat drejtuar Autoritetit nga institucionet kushtetuese dhe autoritetet publike, deri më 31 mars 2020. Afati kufizues në këtë dispozitë u hoq me ndryshimet e bëra së fundi me Ligjin nr.114/2020, miratuar më datë 29.07.2020, që është botuar më datë 26.08.2020 dhe ka hyrë në fuqi më datë 11.09.2020.

Ndërkohë, përveç kësaj pengese, gjatë kësaj procedure u has edhe një pengesë tjetër që afektoi edhe verifikimin e tre kriterëve ligjore ose kualifikimin për kandidatët që kandiduan në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë. Kjo pengesë kishte të bënte me një parashikim të bërë në Kodin Zgjedhor, gjatë kohës që ishin në vijim procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, ku sipas shkronjës “b”, pika 1, të nenit 149, të këtij Kodi përcaktohej se: *“Gjyqtari gjatë ushtrimit të detyrës në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor nuk mund: ...; b) të lëvizet nga detyra në mënyrë të përkohshme apo të përhershme për shkaqe ... apo ngritje në detyrë”*. Në datën 09.09.2020 në Këshillin e Lartë Gjyqësor u zhvillua shorti për përzgjedhjen e gjyqtarëve që do të bënin pjesë në Kolegjin Zgjedhor, bazuar në nenin 146, të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar me Ligjin nr.101/2020 (miratuar më datë 23.07.2020, botuar në Fletoren Zyrtare nr.143, datë 4 Gusht 2020 dhe hyrë në fuqi më datë 19.08.2020). Shorti i zhvilluar, ndër të tjerë, përzgjodhi edhe 4 (*katër*)²³ gjyqtarë që ishin kandidatë për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë. Si rezultat i kësaj, ndërsa sipas shkronjës “b”, pika 1, të

²⁰ Gjyqtarët Etleva Temo, Klodiana Gjyzari, Mariana Shegani dhe Arbena Ahmeti.

²¹ Gjyqtaren Etleva Temo.

²² Gjyqtaret Elona Toro dhe Etleva Temo.

²³ Gjyqtarët Manjola Xhaxho, Sokol Ibi, Asim Vokshi dhe Gentian Medja.

nenit 149, të këtij Kodi përcaktohej ndalimi i promovimit të gjyqtarëve anëtarë të Kolegjit Zgjedhor gjatë kohës që ishin si të tillë, procedura e verifikimit për këta kandidatë nuk vijoi në pritje të shqyrtimit nga Kuvendi i Shqipërisë të nismës ligjore, ndër të tjera, edhe për ndryshimin e kësaj dispozite. Me Ligjin nr.118/2020, u shfuqizua togfjalëshi “*apo ngritje në detyrë*”, në shkronjën “b”, pika 1, të nenit 149, të Kodit Zgjedhor. Ky ligj u botua në Fletoren Zyrtare nr.191, datë 3 nëntor 2020, duke hyrë ai në fuqi më datë 18.11.2020. Menjëherë pas rënies së kësaj pengese ligjore Këshilli shqyrtoi për kandidatët rezultatet për plotësimin e tre kritereve ligjore të kandidimit dhe më pas verifikimin e kritereve të pasurisë dhe figurës, duke miratuar 16 (*gjashtëmbëdhjetë*) akte administrative individuale për kualifikimin e secilit kandidat që kishte kandiduar në procedurat e ngritjes në detyrë pranë Gjykatës së Lartë.

Përveç sa sipër, me qëllim ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, për të gjitha pozicionet e lira pranë kësaj gjykate, më datë 30.10.2020, KZHK-ja i ka propozuar Këshillit edhe tre projektvendime për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, për tre pozicionet e fundit të lira pranë kësaj gjykate, nga një pozicion në secilën fushë të së drejtës (administrative/civile/penale). Këto projektvendime ende nuk janë shqyrtuar në Këshill.

Përfundime në lidhje me procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, gjatë vitit 2020, nga ku rezulton të jenë miratuar:

- **16 (*gjashtëmbëdhjetë*) akte administrative kolektive.** Nga këto, 11²⁴ (*njëmbëdhjetë*) janë akte administrative kolektive për hapjen e procedurave për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, 3 (*tre*)²⁵ akte administrative kolektive janë akte për fillimin e procedurave të verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për kandidatët nga radhët e gjyqtarëve, për pozicionet e lira përkatëse. 1 (*një*)²⁶ akt administrativ kolektiv është shtesë vendimi nr. 268, datë 07.08.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor. 1 (*një*)²⁷ akt administrative kolektiv është për caktimin e relatorit në procedurat e verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit, pasi një nga

²⁴ Vendimet nr. 82, nr. 83, nr. 84, nr. 85, nr. 86 dhe nr. 87, datë 26.02.2020 si dhe Vendimet nr. 241, nr. 242, nr. 243, nr. 244 dhe nr. 245, datë 09.07.2020 të Këshillit.

²⁵ Vendimi nr. 151, datë 06.05.2020 “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për kandidatët nga radhët e gjyqtarëve, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimin nr. 82, datë 26.02.2020 dhe Vendimin nr. 85, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, Vendimi nr. 201, datë 11.06.2020 “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për kandidatët nga radhët e gjyqtarëve, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimin nr. 83, datë 26.02.2020 dhe Vendimin nr. 86, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor” dhe Vendimi nr. 268, datë 07.08.2020 “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për kandidatët nga radhët e gjyqtarëve, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet nr. 84 dhe nr. 87, datë 26.02.2020, si dhe Vendimet nr. 241, nr. 242, nr. 243, nr. 244 dhe nr. 245, datë 09.07.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

²⁶ Vendimi nr. 271, datë 26.08.2020 “Për një shtesë në vendimin nr. 268, datë 07.08.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

²⁷ Vendimi nr. 352, datë 24.09.2020 “Për caktimin e relatorit në procedurat e verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për kandidatët znj. Alma Hicka dhe znj. Saida Dollani”.

relatorët është dorëhequr nga këto procedura dhe Kryetarja e Këshillit ka miratuar këtë dorëheqje;

- **12 (dymbëdhjetë)²⁸ akte administrative individuale** që i përkasin procedurave të verifikimit të plotësimit të tre kritereve të kandidimit për katër pozicionet e para të lira dhe **18 (tetëmbëdhjetë)²⁹ akte administrative individuale** që i përkasin procedurave të verifikimit të plotësimit të tre kritereve të kandidimit për shtatë pozicionet e dyta të lira;
- **4 (katër)³⁰ akte administrative individuale** me anë të të cilave Këshilli ka disponuar përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë të kandidatit, për pozicionin përkatës, për shkak të tërheqjes nga kandidimi;
- **16 (gjashtëmbëdhjetë)³¹ akte administrative individuale** për kualifikimin e kandidatëve për në Gjykatën e Lartë dhe vijimin e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionet përkatëse;
- **1 (një)³² akt administrativ individual** për zbatimin e vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit.

Pengesat e hasura:

- Pavarësisht se Këshilli hapi procedurat e ngritjes në detyrë pranë Gjykatës së Lartë për 6 (*gjashtë*) pozicione të lira, që në datën 26.02.2020, afatet e kandidimit për katër pozicionet e para u pezulluan për shkak të pandemisë Covid-19 dhe u zgjatën, duke përfunduar në fund të muajit maj, gjë që shtyu fillimin e procedurave të verifikimit të kandidatëve;
- Pavarësisht kërkesave të Këshillit, ende nuk ka përfunduar procesi i rivlerësimit kalimtar nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit për (*gjashtë*) kandidatë;

²⁸ Vendimet nr. 210-217, datë 18.06.2020 që i përkasin kandidatëve: Klodian Kurushi, Sokol Ibi, Albana Boksi, Alma Hicka, Klodiana Veizi, Manjola Xhaxho, Gentian Medja dhe Sokol Ngresi, Vendimet nr. 234-236, datë 02.07.2020, që i përkasin kandidatëve: Margarita Buhali, Dhimitër Lara dhe Saida Dollani, si dhe Vendimi nr. 246, datë 09.07.2020 që i përket kandidatit Enton Dhimitri.

²⁹ Vendimet nr. 323-332, datë 17.09.2020, që i përkasin kandidatëve: Etleva Temo, Iliriana Olldash, Sandër Simoni, Sokol Binaj, Arbena Ahmeti, Elona Toro, Klodiana Gjyzari, Mariana Shegani, Nertina Kosova dhe Artur Kalaja; Vendimet nr. 349-351, datë 24.09.2020, që i përkasin kandidatëve: Albana Boksi, Enton Dhimitri dhe Klodian Kurushi; Vendimet nr. 387 dhe nr. 388, datë 07.10.2020 që i përkasin kandidatëve Alma Hicka dhe Saida Dollani; Vendimet nr. 574-576, datë 20.11.2020, që i përkasin kandidatëve: Gentian Medja, Sokol Ibi dhe Asim Vokshi.

³⁰ Vendimi nr. 192, datë 04.06.2020, që i përket kandidatit Gentian Medja, Vendimi nr. 261, datë 23.07.2020, që i përket kandidatës Klodiana Veizi, Vendimi nr. 287, datë 08.09.2020, që i përket kandidatës Albana Boksi dhe Vendimi nr. 290, datë 08.09.2020, që i përket kandidatit Klodian Kurushi.

³¹ Vendimi nr. 371 dhe nr. 373, datë 28.09.2020 që i përket kandidatëve Klodiana Veizi dhe Enton Dhimitri; Vendimet nr. 379-382, datë 02.10.2020, që i përkasin kandidatëve: Margarita Buhali, Dhimitër Lara, Klodian Kurushi dhe Albana Boksi; Vendimet nr. 446 dhe nr. 447, datë 14.10.2020, që i përkasin kandidatëve Iliriana Olldash dhe Saida Dollani; Vendimet nr. 462 dhe nr. 464, datë 19.10.2020, që i përkasin kandidatëve Nertina Kosova dhe Artur Kalaja; Vendimet nr. 490 dhe nr. 491, datë 20.10.2020, që i përkasin kandidatëve Sandër Simoni dhe Sokol Binaj; Vendimet nr. 600-602, datë 04.12.2020, që i përkasin kandidatëve Gentian Medja, Asim Vokshi dhe Manjola Xhaxho; Vendimi nr. 648, datë 29.12.2020, që i përket kandidatit Sokol Ibi.

³² Vendimi nr. 630, datë 10.12.2020 "Për zbatimin e vendimit nr.93, datë 10.11.2020, të Gjykatës Administrative të Apelit dhe fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për kandidaten znj.Saida Dollani, për tre nga katër pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me vendimet nr.241, nr.242, nr.243 dhe nr.244, datë 09.07.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor".

- Mosdërgimi në kohë i informacioneve nga Autoriteti për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, ardhur për shkak të ligjit;
- Përcaktimi i bërë së fundi në nenin 149, të Kodit Zgjedhor, që bllokoj për disa muaj vijimin e procedurave të verifikimit të kriterëve ligjore;
- Mosshqyrtimi nga Gjykata Administrative e Apelit, në afatin e përcaktuar nga ligji, të ankimeve ndaj vendimeve të Këshillit, kjo për shkak numrit të kufizuar të gjyqtarëve të kësaj gjykate, qenies së tyre në proces rivlerësimi, si dhe periudhës së pushimeve vjetore.

2. PËR GJYKATAT E POSAÇME PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

Një nga arritjet e reformës në drejtësi ishte krijimi i gjykatave të posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar. Promovimi i gjyqtarëve pranë këtyre gjykatave ka qenë edhe një nga Rekomandimet që Kuvendi i Shqipërisë kishte për KLGJ-në për vitin 2020.

2.1 Procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar

Pas plotësimit të kuadrit ligjor nëpërmjet miratimit të akteve nënligjore të autorizuar nga ligji, sikurse më sipër është cituar, me propozim të Komisionit, Këshilli ka hapur procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pesë pozicione të lira, nëpërmjet Vendimeve nr. 88, nr. 89, nr. 90, nr. 91 dhe nr. 92, datë 26.02.2020, duke përcaktuar dhe afatet respektive të kandidimit për secilën procedurë ngritje në detyrë³³. Në këtë moment, në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, kanë qenë në detyrë 6 (*gjashtë*) gjyqtarë, ndërsa numri i përgjithshëm i gjyqtarëve të kësaj gjykate është 11 (*njëmbëdhjetë*), përcaktuar me Vendimin e Këshillit nr.286, datë 18.12.2019, në numrin minimal që përcakton Ligji nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, pikërisht shkronja “ç”, pika 4, e nenit 15.

Secili vendim është i ndarë në katër krerë, ku në Kreun I përcaktohet hapja e procedurës dhe shpallja e thirrjes për kandidatura, në Kreun II përcaktohet afati i kandidimit, në Kreun III Informacioni dhe dokumentacioni që i bashkëlidhet kandidimit dhe në Kreun IV procedura e kandidimit. Secilit vendim i bashkëlidhen dy Vetëdeklarimet që duhet të plotësohen nga kandidatët, Vetëdeklarim “Për masa disiplinore” sipas nenit 48, pika 8 të Ligjit për Statusin dhe Vetëdeklarim “Për situatën e papajtueshmërisë ambientale” sipas nenit 8, pika 5 të Ligjit për Statusin.

Kandidatë për ngritjen në detyrë pranë kësaj gjykate, pati vetëm për 4 (*katër*) pozicionet e para, ndërsa për pozicionin e pestë të lirë nuk pati asnjë kandidat. Në kushtet e moskandidimit të asnjë gjyqtari në procedurën si më lart të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe duke qenë se vijonte të ekzistonte ky pozicion si i

³³ Afatet e kandidimit kanë qenë respektivisht 2 javë; 4 javë; 6 javë; 8 javë dhe 10 javë.

libre, mbi propozimin e KZHK-së, me Vendimin nr. 225, datë 02.07.2020, Këshilli ka vendosur rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë pranë kësaj gjykate, për një pozicion të libre. Përveç sa sipër, për shkak se një gjyqtar tjetër i kësaj gjykate, me Vendimin e datës 17.06.2020, të KPK-së, u shkarkua nga detyra, në këtë gjykate u krijua edhe një tjetër pozicion i libre i përhershëm. Për rrjedhojë, mbi propozimin e KZHK-së, me Vendimin nr. 226, datë 02.07.2020, Këshilli ka hapur procedurën e ngritjes në detyrë edhe për këtë pozicion të libre.

Në të dyja procedurat si më lart, për ngritjen në detyrë pranë Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, pra për dy pozicione të lira, brenda afatit të kandidimit deri më datë 26.07.2020, nuk kandidoi asnjë gjyqtar.

Në kushtet e moskandidimit të asnjë gjyqtari në procedurat si më lart të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ndërsa në këtë gjykatë vijonin të ekzistonin dy pozicionet e lira si dhe nevojat urgjente për plotësimin e tyre, mbi propozimet e KZHK-së, me Vendimet nr. 305 dhe nr. 306, datë 10.09.2020, Këshilli ka rihapur procedurat e ngritjes në detyrë për dy pozicione të lira. Edhe në këtë rast, brenda afatit të kandidimit, deri më datë 24.09.2020, nuk kandidoi asnjë gjyqtar.

Pas kësaj, për të njëjtat shkaqe si më lart, ndërsa në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar vijonin të ekzistonin dy pozicione të lira, si dhe nevojat urgjente për plotësimin e tyre, mbi propozimet e KZHK-së, me Vendimet nr. 440 dhe nr. 441, datë 14.10.2020, Këshilli ka vendosur rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në këtë gjykatë, në total për dy pozicione të lira.

Edhe në këtë rast, brenda afatit të kandidimit në këto dy procedura ngritjeje në detyrë pranë Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, afat ky që përfundoi më datë 30.10.2020, nuk kandidoi përsëri asnjë gjyqtar.

Ndërkohë, në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar u hap edhe një pozicion tjetër i libre, për shkak se kandidati³⁴ që kishte kandiduar më herët për këtë pozicion të libre dhe për të cilën vijonte procesi i rivlerësimit kalimtar nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, u tërhoq nga kandidimi për këtë pozicion të libre dhe Këshilli, mbi propozimin e relatorit anëtar të KZHK-së, ka vendosur përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë pranë kësaj gjykate për atë kandidat. Në vijim, në mungesë të kandidatëve në këtë procedurë, me propozim të KZHK-së, Këshilli ka vendosur për *përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë pranë Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e libre të shpallur me Vendimin nr.91, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*

Pas kësaj, për të njëjtat shkaqe si më lart, ndërsa në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ekzistonin pozicione të lira, si dhe nevojat urgjente për plotësimin e tyre, mbi propozimet e KZHK-së, me Vendimet nr. 567, nr. 568 dhe nr. 569, datë

³⁴ Gjyqtarja Irida Kacerja.

20.11.2020, Këshilli ka vendosur rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në këtë gjykatë, në total për tre pozicione të lira.

Edhe në këtë rast, brenda afatit të kandidimit në këto tre procedura ngritjeje në detyrë pranë Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, afat ky që përfundoi më datë 10.12.2020, nuk kandidoi përsëri asnjë gjyqtar.

Vendimet me anë të të cilave janë rihapur procedurat për ngritjen në detyrë pranë Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, kanë të njëjtën përmbajtje sikurse Vendimet fillestare me anë të të cilave janë hapur procedurat e ngritjes në detyrë pranë kësaj gjykate, me të vetmin ndryshim të afatit të kandidimit.

Lidhur me 3 (tre)³⁵ kandidatët që kanë kandiduar për 3 pozicionet e lira që janë hapur më herët në kohë, tashmë ka përfunduar e gjithë faza e parë e verifikimit të kriterëve ligjore për to, përfshirë edhe verifikimin e pasurisë dhe figurës, ndërsa rezultonte se këto candidate kishin kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar. Pengesë për verifikimin e 2 (dy) prej tyre u bë mosdërgimi në kohë i Informacionit nga Autoriteti për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, për të njëjtin shkak të parashtruar edhe më lart, pra afatit të përcaktuar në pikën 2, të nenit 27, të Ligjit nr.45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.

Në lidhje me fazën e parë atë të verifikimit të katër kriterëve ligjore të kandidimit, u verifikuan kriteret e “*përvojës profesionale minimale*”³⁶, e “*dhënies së pëlqimit (ajo edhe familjarët e afërm) për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar*”³⁷, e “*mospasjes masë disiplinore në fuqi*” dhe e “*mosqenies në situatën e*

³⁵ Gjyqtaret Daniela Shirka, Iliriana Olldashi dhe Miliana Muça.

³⁶ Neni 47, pika 5, shkronja “b”, e Ligjit për Statusin përcakton se: “Për pozicionin gjyqtar apeli në Gjykatën e Posaçme të Apelit për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimin të organizuar, magjistrati duhet të ketë ushtruar funksionin jo më pak se dhjetë vjet si gjyqtar, nga të cilat të paktën pesë vjet si gjyqtar për çështjet penale ose si inspektor në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”.

³⁷ Pika 4, e nenit 135, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, përcakton se: “...Kandidatët për gjyqtarë ... në gjykatat e posaçme, si dhe familjarët e afërm të kandidatëve, para emërimit, ... japin pëlqimin për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas ligjit”. Po ashtu, ai gjen parashikim edhe në nenin 47, pika 3, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: “Për të gjitha pozicionet e përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, magjistrati duhet të përmbushë edhe kriteret e tjera dhe kushtet e sigurisë, të parashikuara në ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”. Kjo dispozitë ligjore është një dispozitë referuese e cila referon konkretisht në nenin 48, pikat 1 dhe 2, të Ligjit nr.95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, që përcakton se: “1. Përpara emërimit, kandidatët për gjyqtarë ... në gjykatat kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, ... firmosin deklaratën përkatëse me shkrim për heqjen dorë nga e drejta e tyre për pritshmëri për privatësi (jetë private) në telekomunikimet e tyre dhe në të dhënat financiare, të dhënë në shtojcat B1 e B2 të këtij ligji. Kjo deklaratë firmoset përpara se ata të caktohen me detyrë ... 2. Anëtarët e afërt të familjeve të personave të përmendur në pikën 1 gjithashtu firmosin deklaratën përkatëse për heqjen dorë nga të drejtat, të dhënë në shtojcën B3 të këtij ligji, si tregues se i kuptojnë kushtet...”.

papajtueshmërisë ambientale”, ndërsa rezultoi se të tre kandidatët plotësonin këto katër kritere kandidatimi. Ndërkohë, kriteret e verifikimit u verifikuan edhe kandidatin për pozicionin e shpallur me Vendimin nr. 91, datë 26.02.2020, i cili më pas u tërhoq nga kandidatimi dhe për të përfundoi procedura e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për këtë pozicion të lire, procedurë e cila përfundoi edhe për një kandidat tjetër, i cili edhe ky u tërhoq nga kandidatimi.

Me verifikimin e plotësimit të katër kriterëve ligjore të kandidimit, vijoi procesi i vlerësimit etik dhe profesional, që përfshin gradimin dhe vlerësimin e përshpejtuar, procese që po realizohen nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale.

Në lidhje me fazën e verifikimit të kriterëve të pasurisë dhe figurës, u administrua dokumentacioni i nevojshëm për verifikimin e këtyre kriterëve, verifikim i cili lidhej me periudhën pas dhënies së vendimeve nga organet e rivlerësimit kalimtar.

Tashmë për këto kandidatë pritet përfundimi i proceseve të vlerësimit etik dhe profesional, me përfundimin e të cilëve do të vijohet me procedurën e përzgjedhjes pas renditjes së kandidatëve, me qëllim për të zgjedhur kandidatin e renditur më lart për pozicionet e lira respektive në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Përfundime në lidhje me procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, nga ku rezulton se janë miratuar:

- **14 (katërbëdhjetë)³⁸ akte administrative kolektive** për hapjen dhe/ose rihapjen e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;
- **1 (një)³⁹ akt administrativ kolektiv** për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr.91, datë 26.02.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor;
- **4 (katër)⁴⁰ akte administrative kolektive** për fillimin e procedurave të verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;
- **4 (katër)⁴¹ akte administrative individuale** për verifikimin e katër kriterëve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;

³⁸ Vendimet nr. 88-92, datë 26.02.2020; Vendimet nr. 225, dhe nr. 226, datë 02.07.2020; Vendimet nr. 305 dhe nr. 306, datë 10.09.2020; Vendimet nr. 440 dhe nr. 441, datë 14.10.2020; Vendimet nr. 567, nr. 568 dhe nr. 569, datë 20.11.2020.

³⁹ Vendimi nr. 562, datë 20.11.2020.

⁴⁰ Vendimi nr. 152, datë 06.05.2020; Vendimi nr. 157, datë 15.05.2020, Vendimi nr. 190, datë 04.06.2020 dhe Vendimi nr. 191, datë 04.06.2020.

- **2 (dy)⁴² akte administrative individuale për përfundimin e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar**, për kandidatet respektive, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 91, datë 26.02.2020;
- **3 (tre)⁴³ akte administrative kolektive për kualifikimin e kandidatëve për në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar**.

Pengesat e hasura:

- Pavarësisht se Këshilli hapi procedurat e ngritjes në detyrë Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për 5 (*pesë*) pozicione të lira, që në datën 26.02.2020, afatet e kandidimit u pezulluan për shkak të pandemisë Covid-19 dhe u zgjatën, duke përfunduar në fund të muajit maj, gjë që shtyu fillimin e procedurave të verifikimit;
- Mosdërgimi në kohë i informacioneve nga Autoriteti për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, ardhur për shkak të ligjit;
- Mungesa e kandidimeve për 3 (*tre*) pozicione të lira.

2.2 Procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar

Përveç sa sipër, me propozim të Komisionit, Këshilli ka hapur procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve edhe në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pesë pozicione të lira, nëpërmjet Vendimeve nr. 93, nr. 94, nr. 95, nr. 96 dhe nr. 97, datë 26.02.2020, duke përcaktuar dhe afatet respektive të kandidimit për secilën procedurë ngritje në detyrë⁴⁴. Në këtë moment, në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, kanë qenë në detyrë 11 (*njëmbëdhjetë*) gjyqtarë, ndërsa numri i përgjithshëm i gjyqtarëve të kësaj gjykate është 16 (*gjashtëmbëdhjetë*), përcaktuar me Vendimin e Këshillit nr.286, datë 18.12.2019, në numrin minimal që përcakton Ligji nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, pikërisht shkronja “c”, pika 4, e nenit 15.

Secili vendim është i ndarë në katër krerë, ku në Kreun I përcaktohet hapja e procedurës dhe shpallja e thirrjes për kandidatura, në Kreun II përcaktohet afati i kandidimit, në Kreun II Informacioni dhe dokumentacioni që i bashkëlidhet kandidimit dhe në Kreun IV procedura e kandidimit. Secilit vendim i bashkëlidhen dy Vetëdeklarimet që duhet të plotësohen nga

⁴¹ Vendimi nr. 207, datë 18.06.2020 që i përket kandidatës Miliana Muça, Vendimi nr. 208, datë 18.06.2020 që i përket kandidatës Iliriana Olldashi dhe Vendimi nr. 209, datë 18.06.2020 që i përket kandidatës Daniela Shirka dhe Vendimi nr. 262, datë 23.07.2020 që i përket kandidatës Irida Kacerja.

⁴² Vendimet nr. 289, datë 08.09.2020 që i përket kandidatës Iliriana Olldashi dhe Vendimi nr. 538, datë 05.11.2020 që i përket kandidatës Irida Kacerja.

⁴³ Vendimi nr. 372, datë 28.09.2020 që i përket kandidatës Daniela Shirka, Vendimi nr. 383, datë 02.10.2020 që i përket kandidatës Miliana Muça dhe Vendimi nr. 384, datë 02.10.2020 që i përket kandidatës Iliriana Olldashi.

⁴⁴ Afatet e kandidimit kanë qenë respektivisht 2 javë; 4 javë; 6 javë; 8 javë dhe 10 javë.

kandidatët, Vetëdeklarim “Për masa disiplinore” sipas nenit 48, pika 8 të Ligjit për Statusin dhe Vetëdeklarim “Për situatën e papajtueshmërisë ambientale” sipas nenit 8, pika 5 të Ligjit për Statusin.

Për të pesta procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e parë të lirë kandidoi vetëm 1 (një) kandidat. Ndërsa, për katër pozicionet e tjera, nuk kandidoi asnjë gjyqtar.

Pa përfunduar ende afati i zgjatur i kandidimit, për pozicionin e pestë të lirë, mbi propozimin e KZHK-së, Këshilli, me Vendimet nr. 162, nr. 163 dhe nr. 164, datë 28.05.2020, ka vendosur të rihapte procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për tre pozicione të lira, për të cilat, brenda afatit të kandidimit, deri më datë 22.06.2020, nuk kandidoi asnjë gjyqtar.

Ndërkohë, edhe për pozicionin e pestë të lirë të shpallur fillimisht, nuk kandidoi asnjë gjyqtar.

Në kushtet e moskandidimit të asnjë gjyqtari në katër procedurat si më lart të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe duke qenë se vijonin të ekzistonin këto pozicione si të lira, mbi propozimet e KZHK-së, me Vendimet nr. 220, nr. 221, nr. 222 dhe nr. 223, datë 02.07.2020, Këshilli ka vendosur rihapjen e procedurave të ngritjes në detyrë pranë kësaj gjykate, për katër pozicione të lira.

Ndërkohë pranë kësaj gjykate, për shkak se një gjyqtar tjetër u shkarkua me vendim të KPK-së, u krijua edhe një tjetër pozicion i lirë, i cili do të duhej të plotësohej nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë. Për rrjedhojë, mbi propozim të KZHK-së, Këshilli, me Vendimin nr. 224, datë 02.07.2020, ka vendosur hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë.

Brenda afatit të kandidimit, që ishte deri më datë 26.07.2020, për këto pesë pozicione të lira, për njërin nga ata (*atë të shpallur me Vendimin nr.223*), kandidoi 1 (një) gjyqtar. Për katër pozicionet e tjera të lira, nuk kandidoi asnjë gjyqtar.

Në kushtet e moskandidimit të asnjë gjyqtari në procedurat si më lart të ngritjes në detyrë në Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ndërsa në këtë gjykatë vijonin të ekzistonin katër pozicionet e lira si dhe nevojat urgjente për plotësimin e tyre, mbi propozimet e KZHK-së, Këshilli, me Vendimet nr. 301, nr. 302, nr. 303 dhe nr. 304, datë 10.09.2020, ka rihapur procedurat e ngritjes në detyrë për katër pozicione të lira. Edhe në këtë rast, brenda afatit të kandidimit deri më datë 24.09.2020, nuk kandidoi asnjë gjyqtar.

Për rrjedhojë, për të njëjtat shkaqe si më parë, ndërsa në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar vijonin të ekzistonin katër pozicione të lira, si dhe nevojat urgjente për plotësimin e tyre, mbi propozimet e KZHK-së, Këshilli me Vendimet nr.

436, nr. 437, nr. 438 dhe nr. 439, datë 14.10.2020, ka vendosur rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në këtë gjykatë, në total për katër pozicione të lira.

Brenda afatit të kandidimit për këto procedura ngritjeje në detyrë, afat ky që përfundoi më datë 30.10.2020, nuk kandidoi përsëri asnjë gjyqtar.

Në kushtet e moskandidimit të asnjë gjyqtari në procedurat si më lart të ngritjes në detyrë në Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ndërsa në këtë gjykatë vijonin të ekzistonin katër pozicionet e lira si dhe nevojat urgjente për plotësimin e tyre, mbi propozimet e KZHK-së, Këshilli, me Vendimet nr. 563, nr. 564, nr. 565 dhe nr. 566, datë 20.11.2020, ka rihapur procedurat e ngritjes në detyrë për katër pozicione të lira. Edhe në këtë rast, brenda afatit të kandidimit deri më datë 10.12.2020, nuk kandidoi asnjë gjyqtar.

Ndodhur në këto kushte, Këshilli do të konsiderojë përsëri rihapjen e katër procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Ndërsa, për 2 (dy) kandidatët që kanë kandiduar për ngritjen në detyrë pranë kësaj gjykate, është përfunduar procesi i verifikimit për katër kriteret formale të kandidimit, me qëllim që t'i hapet rrugë procesit të vlerësimit etik dhe profesional, procedura u bllokua në lidhje me verifikimin e kriterëve të pasurisë dhe figurës për shkak se në momentin e kandidimit asnjë nga kandidatët nuk i ishte nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar. Aktualisht, rezulton se njëri nga kandidatët i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar, ndërsa Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, me vendimin e datës 02.10.2020, ka vendosur konfirmimin në detyrë të kandidatit, por ky vendim ende nuk është arsyetuar, me qëllim që të fillojnë të ecin afatet e ankimit. Pra, kemi të bëjmë me një vendim që ende nuk ka marrë formë të prerë.

Për kandidatin tjetër ende nuk ka përfunduar procesi i rivlerësimit kalimtar pavarësisht se për të është kërkuar trajtimi me përparësi i procedurës së rivlerësimit kalimtar.

Përfundime në lidhje me procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar gjatë vitit 2020, nga ku rezulton se janë miratuar:

- **25 (njëzet e pesë)⁴⁵ akte administrative kolektive** për hapjen dhe/ose rihapjen e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;
- **2 (dy)⁴⁶ akte administrative kolektive** për fillimin e procedurave të verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;

⁴⁵ Vendimet nr. 93-97, datë 26.02.2020; Vendimet nr. 162, nr. 163 dhe nr. 164, datë 28.05.2020; Vendimet nr. 220-223, datë 02.07.2020; Vendimi nr. 224, datë 02.07.2020; Vendimet nr. 301-304, datë 10.09.2020; Vendimet nr. 436-439, datë 14.10.2020; Vendimet nr. 563-566, datë 20.11.2020.

- **2 (dy)⁴⁷ akte administrative individuale** për verifikimin e plotësimit të katër kritereve ligjore të kandidimit.

Pengesat e hasura:

- Pavarësisht se Këshilli hapi procedurat e ngritjes në detyrë Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për 5 (*pesë*) pozicione të lira, që në datën 26.02.2020, afatet e kandidimit u pezulluan për shkak të pandemisë Covid-19 dhe u zgjatën, duke përfunduar në fund të muajit maj, gjë që shtyu fillimin e procedurave të verifikimit;
- Pavarësisht kërkesës së Këshillit, ende nuk ka përfunduar procesi i rivlerësimit kalimtar nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit për 1 (*një*) kandidat, ndërsa për kandidatin tjetër edhe pse është konfirmuar në detyrë që më datë 02.10.2020, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ende nuk ka arsyetuar vendimin me qëllim që të ecin afatet e ankimit;
- Mungesa e kandidimeve për 4 (*katër*) pozicione të lira.

3. PËR GJYKATAT E APELIT TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM DHE GJYKATËS ADMINISTRATIVE TË APELIT

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në pikën 1, të nenit 147 dhe në shkronjën “a”, të pikës 1, të nenit 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në pikat 2 dhe 3, të nenit 8, në shkronjën “a”, të pikës 1 dhe në pikën 4, të nenit 47, në pikën 2, në shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 3, në pikat 5, 7 dhe 8, të nenit 48, të Ligjit për Statusin si dhe në shkronjën “a”, të pikës 2, të nenit 61, në shkronjën “ç”, të nenit 86 dhe në shkronjën “b”, të pikës 1, të nenit 97, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe pas plotësimit të kuadrit të plotë ligjor për ngritjen në detyrë të gjyqtarëve, me propozim të KZHK-së, ka hapur procedurat e ngritjes në detyrë pranë gjykatave të apelit të juridiksonit të përgjithshëm dhe Gjykatës Administrative të Apelit, për 16 (*gjashtëmbëdhjetë*) pozicione të lira, shpallur me Vendimet nr. 173-188, datë 28.05.2020. Konkretisht, u hapën:

- a) Me vendimin nr. 173, datë 28.05.2020 procedura e ngritjes në detyrë pranë Gjykatës së Apelit Durrës, për një pozicion të lirë, në fushën e të drejtës civile dhe me Vendimin nr. 174, datë 28.05.2020 procedura e ngritjes në detyrë pranë Gjykatës së Apelit Durrës, për një pozicion të lirë, në fushën e të drejtës penale;
- b) Me vendimin nr. 175, datë 28.05.2020 procedura e ngritjes në detyrë pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, për një pozicion të lirë, në fushën e të drejtës civile;

⁴⁶ Vendimi nr. 153, datë 06.05.2020 “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr.93, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor” dhe Vendimi nr. 269, datë 07.08.2020 “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr.223, datë 02.07.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

⁴⁷ Vendimi nr. 206, datë 18.06.2020 që i përket kandidatit Erjon Çela dhe Vendimi nr. 295, datë 10.09.2020 që i përket kandidatit Erjon Bani.

- c) Me vendimin nr. 176, datë 28.05.2020 procedura e ngritjes në detyrë pranë Gjykatës së Apelit Korçë, për një pozicion të lirë, në fushën e të drejtës civile dhe me Vendimin nr. 177, datë 28.05.2020 procedura e ngritjes në detyrë pranë Gjykatës së Apelit Korçë, për një pozicion të lirë, në fushën e të drejtës penale;
- d) Me vendimin nr. 178, datë 28.05.2020 procedura e ngritjes në detyrë pranë Gjykatës së Apelit Shkodër, për një pozicion të lirë, në fushën e të drejtës civile;
- e) Me vendimet nr. 179-183, datë 28.05.2020 procedurat e ngritjes në detyrë pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, për pesë pozicione të lira, në fushën e të drejtës civile dhe me vendimet nr. 184 dhe nr. 185, datë 28.05.2020 procedurat e ngritjes në detyrë pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, për dy pozicione të lira, në fushën e të drejtës penale;
- f) Me vendimin nr. 186, datë 28.05.2020 procedura e ngritjes në detyrë pranë Gjykatës së Apelit Vlorë, për një pozicion të lirë, në fushën e të drejtës civile;
- g) Me vendimet nr. 187 dhe nr. 188, datë 28.05.2020 procedurat e ngritjes në detyrë pranë Gjykatës Administrative të Apelit, për dy pozicione të lira.

Afati i kandidimit për të gjitha këto pozicione të lira, ishte deri më datë 15.06.2020. Brenda afatit të kandidimit për këto pozicione të lira, kandiduan 21 (*njëzet e një*) kandidatë, për 13 (*trembëdhjetë*) nga pozicionet e lira, ndërsa për 3 (*tre*)⁴⁸ nga pozicionet e lira nuk pati kandidatë.

Pas përfundimit të afatit të kandidimit, mbi propozimin e KZHK-së, Këshilli me vendimin nr. 238, datë 07.07.2020, ka vendosur fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe në Gjykatën Administrative të Apelit dhe pas shortit të hedhur, u caktuan edhe relatorët për secilin kandidat.

Edhe në këtë rast, sikurse në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, faza e verifikimit u nda në dy pjesë, me qëllim për t'i hapur rrugë kryerjes së vlerësimeve etike dhe profesionale të kandidatëve, paralelisht me verifikimin e kriterëve të pasurisë dhe figurës së kandidatëve.

Rezultonte se 13 (*trembëdhjetë*) kandidatë që kishin kandiduar për ngritjen në detyrë pranë këtyre gjykatave, nuk kishin kaluar ende procesin e rivlerësimit kalimtar. Për këtë shkak, Këshilli i ka kërkuar Komisionit të Pavarur të Kualifikimit trajtimin me përparësi të procedurës së rivlerësimit për 12 (*dymbëdhjetë*) kandidatë, ndërkohë që për njërin kandidat, Këshilli i kishte kërkuar, më herët KPK-së trajtimin me përparësi të procedurës së rivlerësimit kalimtar në kuadër të kandidimit të kandidatit në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Rezulton se vetëm për 2 (*dy*)⁴⁹ nga këta kandidatë, KPK-ja doli me vendim gjatë muajit dhjetor 2020.

⁴⁸ Nuk pati kandidatë për pozicionet e lira pranë Gjykatës së Apelit Shkodër, Gjykatës së Apelit Korçë (pozicioni penale) dhe Gjykatës së Apelit Gjirokastrë.

⁴⁹ Gjyqtarët Qemal Zaimi dhe Florjan Kalaja.

Për 21 (*njëzet e një*) kandidatët që kandiduan në procedurat e ngritjes në detyrë në këto gjykata, në fazën e parë të verifikimit relatorët anëtarë të KZHK-së, kanë verifikuar fillimisht tre kriteret ligjore të kandidimit, pikërisht atë të “*përvojës profesionale minimale*”⁵⁰, të “*mospasjes masë disiplinore në fuqi*” dhe të “*mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale*”. Pas verifikimit të plotësimit të tre prej kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm/Gjykatën Administrative të Apelit për 19 (*nëntëmbëdhjetë*)⁵¹ kandidatë, u vijua me procesin e vlerësimit etik dhe profesional, procese që janë duke u zhvilluar nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale. Ky proces vijoi paralelisht me procesin për verifikimin e kriterëve të pasurisë dhe figurës nga KZHK-ja.

Për 6 (*gjashhtë*)⁵² kandidatë që kishin kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar, është administruar informacioni nga institucionet përkatëse dhe, mbi propozimet e relatorëve anëtarë të KZHK-së, është vendosur nga Këshilli kualifikimi i tyre dhe vijimi i procedurave të ngritjes në detyrë në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm/ Gjykatën Administrative të Apelit, sipas pozicionit përkatës ku kishin kandiduar.

Për shkak se pozicioni i lirë pranë Gjykatës Administrative të Apelit, shpallur me vendimin nr. 188, datë 28.05.2020 të Këshillit, u plotësua nga një gjyqtar që gëzonte të drejtën për t’u caktuar në një pozicion në nivel apeli, me propozim të KZHK-së, është miratuar Vendimi i Këshillit nr. 298, datë 07.10.2020, me anë të të cilit u vendos përfundimi i procedurës së ngritjes në detyrë pranë Gjykatës Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e tij nr. 188, datë 28.05.2020. Gjithashtu, në këtë vendim, me qëllim mospenalizimin e kandidatit që kishte kandiduar në këtë procedurë ngritjeje në detyrë (*ndërkohë që kandidatët e tjerë kishin kandiduar edhe për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr. 187, datë 28.05.2020*), Këshilli ka vendosur që kandidimi i këtij kandidati, të konsiderohej i vlefshëm për procedurën e ngritjes

⁵⁰ Në rastin e ngritjes në detyrë në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm, në nenin 47, pika 4, të Ligjit për Statusin, përcaktohet se: “*Magjistrati mund të ngrihet në detyrë në pozicione pranë gjykatave ose prokurorive të shkallës së dytë, nëse ka ushtruar funksionin jo më pak se shtatë vjet në shkallën e parë, nga të cilat të paktën pesë vjet në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionin e lirë, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar*”.

⁵¹ Vendimi nr. 276, datë 08.09.2020 që i përket kandidatës Alma Ahmeti, Vendimi nr. 277, datë 08.09.2020 që i përket kandidatës Elona Mihali, Vendimi nr. 278, datë 08.09.2020 që i përket kandidatës Arta Duka, Vendimi nr. 279, datë 08.09.2020 që i përket kandidatës Irida Kacerja, Vendimi nr. 280, datë 08.09.2020 që i përket kandidatës Emona Muçi, Vendimi nr. 281, datë 08.09.2020 që i përket kandidatës Esmeralda Xhili, Vendimi nr. 282, datë 08.09.2020 që i përket kandidatës Igerta Hysi, Vendimi nr. 283, datë 08.09.2020 që i përket kandidatës Klodiana Veizi, Vendimi nr. 284, datë 08.09.2020 që i përket kandidatës Migena Laska, Vendimi nr. 285, datë 08.09.2020 që i përket kandidatit Qemal Zaimi, Vendimi nr. 294, datë 10.09.2020 që i përket kandidatit Ilir Përdeda dhe Vendimi nr. 296, datë 10.09.2020 që i përket kandidatit Erjon Bani, Vendimi nr. 307, datë 10.09.2020 që i përket kandidatit Engert Pëllumbi, Vendimi nr. 308, datë 10.09.2020 që i përket kandidatit Florjan Kalaja, Vendimi nr. 309, datë 10.09.2020 që i përket kandidatës Marsela Pepi, Vendimi nr. 310, datë 10.09.2020 që i përket kandidatës Ornela Naqellari, Vendimi nr. 571, datë 20.11.2020 që i përket kandidatit Engert Pëllumbi (*edhe në kuadër të kandidimit të tij për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr. 392, datë 07.10.2020*), Vendimi nr. 572, datë 20.11.2020 që i përket kandidatës Arbena Ahmeti, Vendimi nr. 575, datë 20.11.2020 që i përket kandidatit Sokol Ibi.

⁵² Vendimi nr. 463, datë 19.10.2020 që i përket kandidatës Ornela Naqellari, Vendimi nr. 499, datë 21.10.2020 që i përket kandidatës Klodiana Veizi, Vendimi nr. 561, datë 13.11.2020 që i përket kandidatës Erjol Roshi, Vendimi nr. 649, datë 29.12.2020 që i përket kandidatës Alma Kolgjoka, Vendimi nr. 650, datë 29.12.2020 që i përket kandidatës Emona Muçi, vendimi nr. 651, datë 29.12.2020 që i përket kandidatës Esmeralda Xhili.

në detyrë pranë Gjykatës Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e tij nr. 187, datë 28.05.2020.

Ndërkohë, për shkak të moskandidimit të kandidatëve në disa procedura të ngritjes në detyrë pranë gjykatave të apelit të juridiksionit të përgjithshëm, Komisioni ka propozuar disa herë rihapjen e tyre me qëllim plotësimin e vendeve vakante të përhershme pranë këtyre gjykatave.

Këshilli ka miratuar 3 (tre) akte administrative kolektive për rihapjen e procedurave për ngritjen në detyrë pranë gjykatave të apelit të juridiksionit të përgjithshëm e më konkretisht:

1. Vendimi nr. 227, datë 02.07.2020 “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrën e gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile”;
2. Vendimi nr. 228, datë 02.07.2020 “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Korçë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale”;
3. Vendimi nr. 229, datë 02.07.2020 “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Shkodër, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile”.

Për shkak se brenda afatit të kandidimit⁵³ për këto pozicione të lira nuk pati kandidatë, Komisioni ka propozuar rihapjen e tyre dhe Këshilli ka miratuar vendimet si më poshtë vijon:

1. Vendimi nr. 298, datë 10.09.2020 “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Shkodër, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile”;
2. Vendimi nr. 299, datë 10.09.2020 “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Korçë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale”;
3. Vendimi nr. 300, datë 10.09.2020 “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrën e gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile”.

Për shkak se brenda afatit të kandidimit⁵⁴ për këto pozicione të lira nuk pati kandidatë, Komisioni ka propozuar rihapjen e tyre dhe Këshilli ka miratuar vendimet si më poshtë vijon:

1. Vendimi nr. 389, datë 07.10.2020 “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrën e gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile”;

⁵³ Afati i kandidimit ishte dy javë nga dita e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të njoftimit për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë.

⁵⁴ Edhe në këtë rast afati i kandidimit ishte dy javë nga dita e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të njoftimit për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë.

2. Vendimi nr. 390, datë 07.10.2020 “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Korçë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale”;
3. Vendimi nr. 391, datë 07.10.2020 “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Shkodër, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile”.

Në këtë mbledhje të Këshillit, mbi propozimet e KZHK-së, u hapën procedurat e ngritjes në detyrë edhe të gjashtë pozicioneve të tjera të lira në gjykatat me juridiksion të përgjithshëm, konkretisht miratuar me:

1. Vendimin nr. 392, datë 07.10.2020 “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Durrës, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile”;
2. Vendimin nr. 393, datë 07.10.2020 “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Shkodër, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale”;
3. Vendimin nr. 394, datë 07.10.2020 “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile”;
4. Vendimin nr. 395, datë 07.10.2020 “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile”;
5. Vendimin nr. 396, datë 07.10.2020 “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale”;
6. Vendimin nr. 397, datë 07.10.2020 “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Vlorë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale”.

Afati i kandidimit për të gjitha këto procedura ngritjeje në detyrë ishte deri më datë 23.10.2020.

Kandidatë për procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve, pranë gjykatave të apelit të juridiksionit të përgjithshëm pati vetëm në 5 (*pesë*)⁵⁵ pozicione të lira, ku kandiduan gjithsej 8 (*tetë*) kandidatë, 3 (*tre*) prej të cilëve kishin kandiduar edhe në procedurat e mëparshme të ngritjes në detyrë në gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm dhe Gjykatën Administrative të Apelit, ndërsa 5 (*pesë*) prej tyre kandiduan rishtazi.

Me kalimin e afatit të kandidimit, mbi propozimin e KZHK-së, Këshilli ka miratuar Vendimin nr. 541, datë 05.11.2020, me anë të të cilit është vendosur fillimi i procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në gjykatat e apelit të juridiksionit të

⁵⁵ Konkretisht pati kandidatë vetëm në këto pozicione të lira, të shpallura me Vendimet nr. 389, nr. 392, nr. 394, nrr. 395 dhe nr. 396, datë 07.10.2020.

përgjithshëm, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet e tij të datës 07.10.2020, duke caktuar relatorët përkatës për secilin nga kandidatët që kishin kandiduar rishtazi, ndërsa për kandidatët që kishin kandiduar edhe më parë në procedura të tjera ngritjeje në detyrë që ishin ende në proces, u vendos që procedurat e verifikimit edhe në këtë rast do të kryheshin nga të njëjtët relatorë.

Për 5 (*pesë*)⁵⁶ kandidatë që kandiduan rishtazi rezultoi se nuk kishin kaluar procesin e rivlerësimit kalimtar dhe për këtë shkak, Këshilli, sikurse edhe më herët kishte vepruar, i ka kërkuar Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, të trajtonte me përparësi kandidatët në procesin e rivlerësimit kalimtar.

Për 7 (*shtatë*) kandidatë që kishin kandiduar në këto procedura ngritjeje në detyrë, me propozim të KZHK-së janë miratuar nga Këshilli vendimet⁵⁷ për verifikimin e plotësimit të tre kriteret ligjore të kandidimit, i cili i hapi rrugë vlerësimeve etike dhe profesionale të gjyqtarëve, si kusht për të qenë kandidatë në procedurat e mëtejshme të përzgjedhjes për ngritjen në detyrë.

Për shkak të moskandidimit të asnjë kandidati, mbi propozimet e KZHK-së, u rihapën nga Këshilli procedurat e ngritjes në detyrë pranë Gjykatës së Apelit Korçë dhe Shkodër, konkretisht duke u miratuar:

1. Vendimi nr. 542, datë 05.11.2020 “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Korçë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale”;
2. Vendimi nr. 543, datë 05.11.2020 “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Shkodër, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile”;
3. Vendimi nr. 544, datë 05.11.2020 “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Shkodër, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale”;
4. Vendimi nr. 545, datë 05.11.2020 “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Vlorë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale”.

Në procedurën e ngritjes në detyrë pranë Gjykatës së Apelit Vlorë, pati një kandidat dhe Këshilli, mbi propozimin e KZHK-së, ka miratuar Vendimin nr. 623, datë 10.12.2020 për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Vlorë, për një pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin

⁵⁶ Gjyqtarët Luveda Dardha, Lutfie Celami, Rezarta Paja, Sokol Pina dhe Marsela Dervishi.

⁵⁷ Vendimi nr. 570, datë 20.11.2020 që i përket kandidatës Migena Laska, Vendimi nr. 624, datë 10.12.2020 që i përket kandidatës Marsela Dervishi, Vendimi nr. 625, datë 10.12.2020 që i përket kandidatës Luveda Dardha, Vendimi nr. 626, datë 10.12.2020 që i përket kandidatës Rezarta Aliu, Vendimi nr. 627, datë 10.12.2020 që i përket kandidatës Lutfie Celami, Vendimi nr. 628, datë 10.12.2020 që i përket kandidatës Irida Kacerja, Vendimi nr. 629, datë 10.12.2020 që i përket kandidatit Sokol Pina.

nr.545, datë 05.11.2020, të Këshillit, duke caktuar edhe relatorin përkatës nga anëtarët e KZHK-së për të ndjekur këtë procedurë.

Për shkak moskandidimi, mbi propozimet e KZHK-së, Këshilli ka rihapur përsëri procedurat e ngritjes në detyrë pranë këtyre dy gjykatave e më konkretisht:

1. Vendimi nr. 619, datë 10.12.2020 “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Korçë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale”;
2. Vendimi nr. 620, datë 10.12.2020 “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Shkodër, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile”;
3. Vendimi nr. 621, datë 10.12.2020 “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Shkodër, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale”.

Ndërkohë, në procedurat e ngritjes në detyrë në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm, pati edhe tërheqje nga kandidimi nga disa kandidatë, e për rrjedhojë, mbi propozimet e relatorëve anëtarëve të KZHK-së, Këshilli ka miratuar 5 (pesë)⁵⁸ vendime për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë të kandidatëve, në pozicionet respektive ku ata kishin kandiduar.

Përfundime në lidhje me procedurat e ngritjes në detyrë në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe Gjykatën Administrative të Apelit gjatë vitit 2020, nga ku rezulton se janë miratuar:

- **39 (tridhjetë e nëntë) akte administrative kolektive**, nga të cilat 38 (tridhjetë e tetë) për hapjen dhe/ose rihapjen e procedurave të ngritjes në detyrë në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe Gjykatën Administrative të Apelit dhe 1 (një) akt administrativ kolektiv për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë pranë Gjykatës Administrative të Apelit;
- **3 (tre) akte administrative kolektive** për fillimin e procedurave të verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe Gjykatën Administrative të Apelit;
- **26 (njëzet e gjashtë) akte administrative individuale** që i përkasin procedurave të verifikimit të plotësimit të tre kriterëve të kandidimit;
- **6 (gjashtë) akte administrative individuale** për kualifikimin e kandidatëve në procedurat e ngritjes në detyrë në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe Gjykatën Administrative të Apelit;

⁵⁸ Vendimi nr. 286, datë 08.09.2020 që i përket kandidatit Erjon Bani, Vendimi nr. 288, datë 08.09.2020 që i përket kandidates Arbena Ahmeti, Vendimi nr. 536, datë 05.11.2020 që i përket kandidatit Engert Pëllumbi, Vendimi nr. 537, datë 05.11.2020 që i përket kandidatit Erjon Bani, Vendimi nr. 539, datë 05.11.2020 që i përket kandidates Migena Laska.

- **5 (pesë) akte administrative individuale** për përfundimin e procedurave të ngritjes në detyrë në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm, për shkak të tërheqjes së kandidatit nga kandidimi në pozicionet përkatëse.

Pengesat e hasura:

- Pavarësisht kërkesës së Këshillit, ende nuk ka përfunduar procesi i rivlerësimit kalimtar nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit për kandidatët që nuk kishin kaluar procesin e rivlerësimit kalimtar në momentin e kandidimit për ngritjen në detyrë në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe Gjykatën Administrative të Apelit;
- Mungesa e kandidimeve për disa nga pozicionet e lira në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm, gjë që ka çuar në rihapjen disa herë të këtyre procedurave të ngritjes në detyrë.

IV. MBI BASHKËPUNIMIN ME SHKOLLËN E MAGJISTRATURËS

4.1 Bashkëpunimi me Shkollën e Magjistraturës në kuadër të përcaktimit të numrit të kandidatëve për gjyqtarë, për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë që do të pranohen në programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2020-2021

Në respektim të detyrimeve të përcaktuara në pikën 1, të nenit 29, të Ligjit për Statusin në janar të çdo viti, Këshilli duhet të përcaktojë dhe publikojë numrin maksimal të kandidatëve magjistratë (*profili gjyqtar*) që pranohen në formimin fillestar për vitin e ri akademik. Krahas kësaj, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në pikën 2, të nenit 53, të Ligjit nr. 98/2016, “*Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë*”, Këshilli duhet të përcaktojë dhe publikojë edhe numrin maksimal të kandidatëve këshilltarë dhe ndihmës ligjorë, që pranohen në formimin fillestar për vitin e ri akademik.

Nisur nga këto detyrime ligjore, Këshilli i duhej që, brenda janarit 2020, të përcaktonte numrin maksimal të kandidatëve magjistratë/profili gjyqtar, të kandidatëve këshilltarë dhe ndihmës ligjorë, që duhet të pranoheshin në formimin fillestar të Shkollës së Magjistraturës, për vitin e ri akademik 2020-2021. Për këtë qëllim, Komisioni ka përgatitur Projektvendimin “*Për numrin maksimal të kandidatëve magjistratë/profili gjyqtar, të kandidatëve këshilltarë dhe ndihmës ligjorë, që duhet të pranohen në formimin fillestar të Shkollës së Magjistraturës, për vitin e ri akademik 2020-2021*”, duke marrë në analizë një sërë treguesish dhe faktorësh të rëndësishëm që lidheshin me këtë proces të rëndësishëm⁵⁹.

⁵⁹ Këta tregues dhe faktorë lidheshin me situatën në të cilën ishte sistemi gjyqësor, me ndikimin që ka në sistemin gjyqësor implementimi i reformës në drejtësi, me kapacitetet e Shkollës së Magjistraturës në lidhje me ofrimin e formimit fillestar, të vlerësuara në harmoni me projeksionin/vizionin e Këshillit për sistemin gjyqësor në një periudhë afatmesme dhe afatgjatë.

Mbi propozimin e Komisionit, Këshilli ka miratuar Vendimin nr. 31⁶⁰, datë 23.01.2020 “*Mbi numrin e kandidatëve që do të pranohen në Programin e Formimit Fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2020-2021*”, në përmbajtje të të cilit u përcaktua: (i) Numri i kandidatëve për magjistratë, profili gjyqtar, që pas kalimit të testimit profesional, do të pranohen në programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2020-2021, do të jetë 40 (*dyzet*), (ii) Numri i kandidatëve për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë, që pas kalimit të testimit profesional, do të pranohen për të ndjekur për një periudhë prej nëntë muajsh programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2020-2021, do të jetë 25 (*njëzet e pesë*).

Në kuadër të këtij procesi, është miratuar Vendimi nr. 62, datë 30.01.2020 “*Për ngritjen e Komisionit të Përkohshëm për verifikimin e plotësimit të kriterëve ligjorë të pranimit në provimin e pranimit në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2020-2021, të kandidatëve për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë*”, i cili verifikoi plotësimin e kriterëve ligjorë të pranimit në provimin e pranimit në Shkollën e Magjistraturës, të kandidatëve këshilltarë dhe ndihmës ligjorë.

4.2 Bashkëpunimi me Shkollën e Magjistraturës në kuadër të verifikimit të kandidatëve fitues për në formimin fillestar për magjistratë në Shkollën e Magjistraturës

Këshilli i Lartë Gjyqësor në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës ka ndërmarrë procedurën e verifikimit të pasurisë dhe figurës së kandidatëve fitues për në formimin fillestar për magjistratë, profili gjyqtar, për në Shkollën e Magjistraturës për vitin 2019-2020, sipas përcaktimeve ligjore, gjithsej për 26 (*njëzet e gjashtë*) kandidatë. Rezultoi se për dy kandidatë, për shkak të zgjatjes së procedurës së verifikimit në lidhje me konstatimet e bëra, procedura e verifikimit është përmbyllur në janar 2020, me Vendimet nr. 20⁶¹ dhe nr. 21⁶², datë 09.01.2020.

Gjithashtu, Këshilli në bashkëpunim me Shkollën ka ndërmarrë procedurën e verifikimit të pasurisë dhe figurës së kandidatëve fitues për në formimin fillestar për magjistratë, profili gjyqtar, për në Shkollën e Magjistraturës për vitin 2020-2021. Pavarësisht gatishmërisë së Këshillit që ky proces të përfundonte në kohë, me qëllim që të hënën e parë të muajit tetor të gjithë kandidatët e kualifikuar të fillonin rregullisht Shkollën, i gjithë procesi duke filluar që nga konkursi në Shkollën e Magjistraturës, u shtynë për shkak të situatës së krijuar nga Covid-19. Vetëm në muajin korrik 2020, me Shkresën nr. 492 prot., datë 17.07.2020, Shkolla e Magjistraturës ka përcjellë pranë Këshillit listën e kandidatëve fitues për gjyqtar për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2020-2021, gjithsej 40 (*dyzet*) kandidatë.

Menjëherë, mbi propozimin e KZHK-së, me Vendimin nr. 257, datë 20.07.2020, Këshilli ka vendosur fillimin e procedurës së verifikimit të kandidatëve për në formimin fillestar për

⁶⁰ Me vendimin nr. 58, datë 29.01.2020 “Për korrigjimin e gabimit në shkrim në vendimin nr. 31, datë 23.01.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, mbi këtë Vendim të Këshillit është bërë një korrigjim i gabimit në shkrim.

⁶¹ Ky vendim i përket kandidatës Aurora Alimadhi.

⁶² Ky vendim i përket kandidatit Vladimir Cjapi.

magjistrat, profili gjyqtar, në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2020-2021. Gjithashtu, Këshilli për të fituar kohë, ka vendosur të rikonsiderojë afatet e procedurës së verifikimit, duke i shkurtuar ato dhe njoftuar për këtë kandidatët, në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës.

Megjithatë, procesi hasi në vështirësi për shkak se një pjesë e periudhës së verifikimit koïncidoi me muajin gusht, gjatë të cilit subjektet publike dhe private funksionojnë me personel të reduktuar për shkak të kryerjes nga punonjësit të pushimeve vjetore, çka çoi në vonesa të dërgimit të informacioneve dhe raportimeve të kërkuara nga Këshilli, si dhe mosdërgimi i informacioneve dhe raportimeve nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Gjendjes Civile, Prokuroria e Përgjithshme dhe Shërbimi Informativ Shtetëror.

Kështu, në kuadër të zbatimit të Ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, mbi kërkesë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Gjendjes Civile, vetëm në datën 01.10.2020, dërgoi të dhënat për përbërësit e gjendjes civile për 25 (*njëzet e pesë*) kandidatë, pas verifikimeve të bëra në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile të vitit 2010 dhe në zyrat përkatëse të gjendjes civile. Vetëm për 15 (*pesëmbëdhjetë*) prej tyre nuk ishin konstatuar ndryshime në përbërësit e gjendjes civile, ndërkohë që për të tjerët ishte e nevojshme verifikimi i mëtejshëm i të dhënave.

Për rrjedhojë, Këshilli në Mbledhjen Plenare të datës 09.10.2020, mbi propozimet e relatorëve anëtarë të KZHK-së, ka kualifikuar 15 (*pesëmbëdhjetë*)⁶³ kandidatë për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për magjistrat, profili gjyqtar.

Më vonë, në kohë të ndryshme, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Gjendjes Civile, dërgoi të dhënat për përbërësit e gjendjes civile për të tjerë kandidatë, e për rrjedhojë, mbi propozimet e relatorëve anëtarë të KZHK-së, Këshilli në Mbledhjen Plenare të datës 14.10.2020 ka vendosur kualifikimin e 3 (*tre*)⁶⁴ kandidatëve të tjerë, në Mbledhjen Plenare të datës 19.10.2020 ka vendosur kualifikimin e 8 (*tetë*)⁶⁵ kandidatëve të tjerë, ndërsa në Mbledhjen Plenare të datës 20.10.2020 ka vendosur kualifikimin e 4 (*katër*)⁶⁶ kandidatëve të tjerë.

⁶³ Vendimi nr. 407, datë 09.10.2020 i përket kandidatit Artan Çirraga, Vendimi nr. 408, datë 09.10.2020 i përket kandidatit Estjon Venxha, Vendimi nr. 409, datë 09.10.2020 i përket kandidatit Mikel Hysometaj, Vendimi nr. 410 i përket kandidatit Romeo Merruko, Vendimi nr.411, datë 09.10.2020 i përket kandidates Eglantina Biba, Vendimi nr. 412, datë 09.10.2020 i përket kandidates Eranda Cufo, Vendimi nr. 413, datë 09.10.2020 i përket kandidatit Lirim Bulica, Vendimi nr. 414, datë 09.10.2020 i përket kandidates Lumturi Zhupa, Vendimi nr. 415, datë 09.10.2020 i përket kandidates Nertila Përallaj, Vendimi nr. 416, datë 09.10.2020 i përket kandidates Entela Selmanaj, Vendimi nr.417, datë 09.10.2020 i përket kandidatit Elvis Sulejmani, Vendimi nr. 418, datë 09.10.2020 i përket kandidatit Fjoralb Behari, Vendimi nr. 419, datë 09.10.2020 i përket kandidatit Genci Busho, Vendimi nr. 420, datë 09.10.2020 i përket kandidatit Ilirjan Hysa, Vendimi nr. 421, datë 09.10.2020 i përket kandidatit Klajdi Tërova.

⁶⁴ Vendimi nr. 443, datë 14.10.2020 që i përket kandidates Edlira Çota, Vendimi nr. 444, datë 14.10.2020 që i përket kandidates Ina Yzellari, Vendimi nr. 445, datë 14.10.2020 që i përket kandidates Enkeleda Halilaj.

⁶⁵ Vendimi nr. 454, datë 19.10.2020 që i përket kandidatit Renis Sheshi, Vendimi nr. 455, datë 19.10.2020 që i përket kandidatit Orald Hoxha, Vendimi nr. 456, datë 19.10.2020 që i përket kandidates Dorina Alushi, Vendimi nr. 457, datë 19.10.2020 që i përket kandidates Ajshe Xhafa, Vendimi nr. 458, datë 19.10.2020 që i përket kandidates Anisa Brinja (Tepelena), Vendimi nr. 459, datë 19.10.2020 që i përket kandidates Dorentina Mulaj, Vendimi nr. 460, datë

Dy⁶⁷ kandidatë të tjerë, procedura e të cilëve u zgjat në kohë në kuadër të verifikimit të figurës, u kualifikuan nga Këshilli në mbledhjen plenare të datës 28.10.2020, mbi propozimet e relatorëve anëtarë të KZHK-së. Pesë⁶⁸ kandidatë të tjerë, për të cilët pritej verifikimi nga Prokuroria e Përgjithshme në kuadër të kriterit të figurës, janë kualifikuar në Mbledhjen plenare të datës 04.12.2020, mbi propozimet e relatorëve anëtarë të KZHK-së,.

Ndërkohë, për dy kandidatë të tjerë shqyrtimi i rezultateve të verifikimit është shtyrë nga Këshilli, ndërsa ka konsideruar të nevojshëm verifikimin e disa të dhënave në kuadër të këtij procesi, ndërkohë që për një kandidat procesi i verifikimit nuk ka përfunduar, ndërsa është konsideruar i domosdoshëm verifikimi i thelluar i të dhënave lidhur me kriterin e pasurisë, proces që po vijon në bashkëpunim me ILDKPKI-në dhe me subjekte të tjera.

Pra, deri në këtë moment, nga 40 (*dyzet*) kandidatë janë verifikuar dhe kualifikuar për në Shkollën e Magjistraturës 37 (*tridhjetë e shtatë*) kandidatë, janë në shqyrtim përpara Këshillit procedurat e verifikimit të 2 (*dy*) kandidatëve, ndërsa për 1 (një) kandidat vijon ende verifikimi i thelluar i të dhënave në lidhje me kriterin e pasurisë.

Pasur parasysh kohën e shkurtër që kishte në dispozicion Këshilli, vetëm dy muaj (*gusht dhe shtator*), ku muaji gusht përkon me kohën e marrjes së pushimeve vjetore për shumicën e punonjësve në subjektet publike dhe private e për rrjedhojë punojnë me staf të reduktuar, marrë parasysh numrin e konsiderueshëm të kandidatëve që duhet të verifikoheshin, si dhe mosdërgimin në kohë të shpejtë të informacioneve dhe raportimeve sidomos nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Gjendjes Civile dhe Prokuroria e Përgjithshme, Këshilli ka treguar vendosmëri dhe arriti që brenda muajit tetor të përmbyllte shumicën e procedurave të verifikimit, me qëllim që kandidatët e kualifikuar të fillonin pa vonesë Shkollën e Magjistraturës për vitin akademik 2020-2021.

Përfundime në lidhje me procedurat e verifikimit të kandidatëve për magistratë, profili gjyqtar, për në Shkollën e Magjistraturës, viti akademik 2019-2020 dhe 2020-2021, nga ku rezulton se:

- Janë kualifikuar 2 (*dy*) kandidatë për magistratë, profili gjyqtar, për në Shkollën e Magjistraturës, viti akademik 2019-2020, si dhe 37 (*tridhjetë e shtatë*) kandidatë për

19.10.2020 që i përket kandidates Elona Mërtiri, Vendimi nr. 461, datë 19.10.2020 që i përket kandidates Edona Vajushi.

⁶⁶ Vendimi nr. 486, datë 20.10.2020 që i përket kandidates Alba Ngresi, Vendimi nr. 487, datë 20.10.2020 që i përket kandidatit Aldi Kareco, Vendimi nr. 488, datë 20.10.2020 që i përket kandidatit Ervin Kore, Vendimi nr. 489, datë 20.10.2020 që i përket kandidatit Armand Shkurta.

⁶⁷ Vendimi nr. 534, datë 28.10.2020 që i përket kandidatit Entiljano Spahiu, Vendimi nr. 535, datë 28.10.2020 që i përket kandidates Mevlute Çausi.

⁶⁸ Vendimi nr. 603, datë 04.12.2020 që i përket kandidates Elena Tafa, Vendimi nr. 604, datë 04.12.2020 që i përket kandidates Juliana Pjetri, Vendimi nr. 605, datë 04.12.2020 që i përket kandidates Klodiana Kryeziu, Vendimi nr. 606, datë 04.12.2020 që i përket kandidates Olta Cenaj, Vendimi nr. 607, datë 04.12.2020 që i përket kandidatit Noel Veizi.

magjistratë, profili gjyqtar, për në Shkollën e Magjistraturës, viti akademik 2020-2021, pra gjithsej janë miratuar **39 (tridhjetë e nëntë) akte administrative individuale** kualifikuese për kandidatët për magjistratë;

- Procedurat e verifikimit për 2 (dy) kandidatë janë për shqyrtim në Këshill, ndërsa vijon procedura e verifikimit ende për një kandidat, nga ana e Komisionit, për shkak të konstatimeve të hasura gjatë procedurës së verifikimit në lidhje me kriterin e pasurisë;
- Është miratuar **1 (një) akt administrative kolektiv** me anë të të cilit Këshilli ka vendosur fillimin e procedurës së verifikimit të kandidatëve për në formimin fillestar për magjistrat, profili gjyqtar, në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2020-2021.

Pengesat e hasura:

- Procesi i rekrutimit të kandidatëve për gjyqtarë, për shkak të masave kufizuese për parandalimin e përhapjes së Covid-19, është shtyrë në kohë, çka ka sjell kufizimin e kohës në dispozicion të Këshillit për verifikimin kriterëve të pranimit në programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, përfshirë të pasurisë dhe të figurës;
- Një pjesë e periudhës së verifikimit koïncidoi me muajin gusht, gjatë të cilit subjektet publike dhe private funksionojnë me personel të reduktuar për shkak të kryerjes nga punonjësit të pushimeve vjetore, çka ka çuar në vonesa të dërgimit të informacioneve dhe raportimeve të kërkuara nga Këshilli;
- Mosdërgimi i informacioneve dhe raportimeve nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Gjendjes Civile, Prokuroria e Përgjithshme dhe Shërbimi Informativ Shtetëror;
- Nevoja për verifikime të mëtejshme për shkak të konstatimeve të hasura gjatë procedurës për verifikimin e kriterit të pasurisë dhe figurës.

V. MBI EMËRIMIN E MAGJISTRATËVE

5.1 Emërimi i magjistratëve që kanë përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin akademik 2018-2019

Në Kreun II, Pjesa III të Ligjit për Statusin rregullohet procedura e emërimit të kandidatit magjistrat i diplomuar nga Shkolla e Magjistraturës dhe më pas në Kreun III, Pjesa III të Ligjit për Statusin rregullohet procedura e caktimit në pozicion të gjyqtarëve të sapo emëruar.

Në vitin 2019, Shkolla e Magjistraturës, ka përcjellë pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor listën e magjistratëve të sapodiplomuar për vitin akademik 2018-2019, gjithsej 15 (*pesëmbëdhjetë*) kandidatë dhe Këshilli, mbi propozimin e KZHK-së, ka filluar menjëherë procedurat e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të emërimit të magjistratëve.

Në përfundim të procedurave të verifikimit, mbi propozimet e relatorëve anëtarë të KZHK-së, Këshilli ka vendosur kualifikimin e 14 (*katërmëdhjetë*) kandidatëve për magjistratë, ndërsa për 1 (*një*) kandidat ka vendosur skualifikimin e tij për shkak të problematikave në lidhje me kriterin e pasurisë. Ky vendim i Këshillit, është ankimuar nga magjistrati i diplomuar në Gjykatën

Administrative të Apelit, e cila me vendimin nr. 262, datë 23.12.2019 vendosi pranimin e padisë, shfuqizimin e vendimit të Këshillit, kualifikimin për emërim të kandidatit, si dhe detyrimin e Këshillit për të vijuar procedurën e emërimit si gjyqtar të kandidatit. Ndaj këtij vendimi Këshilli ka paraqitur rekurs⁶⁹ në Gjykatën e Lartë, megjithatë, në kushtet kur ky vendim i Gjykatës Administrative të Apelit është i formës së prerë, Këshilli ishte i detyruar për ta zbatuar atë, e për rrjedhojë, vijoi procedurën e emërimit të këtij kandidati si dhe të 14 kandidatëve të tjerë.

Këshilli në mbledhjen plenare të datës 09.01.2020, mbi propozimet e KZHK-së, ka vendosur emërimin gjyqtar të 15 (*pesëmbëdhjetë*)⁷⁰ magjistratëve të kualifikuar, ndërsa me vendimin nr. 25, datë 14.01.2020, mbi propozimin e KZHK-së, Këshilli ka shpallur pozicionet e lira për gjyqtarët e emëruar më datë 09.01.2020. Më pas, në mbledhjen plenare të datës 29.01.2020, mbi propozimet e KZHK-së, Këshilli ka vendosur caktimin në pozicion të gjyqtarëve të emëruar⁷¹.

Përfundime në lidhje me procedurat e emërimit të magjistratëve që kanë përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin akademik 2018-2019, nga ku rezulton se janë miratuar:

- **1 (një) akt administrative kolektiv** për shpalljen e pozicioneve të lira për gjyqtarët e emëruar më datë 09.01.2020, që kishin përfunduar Shkollën e Magjistraturës, në vitin akademik 2018-2019;
- **30 (tridhjetë) akte administrative individuale**, nga të cilat 15 (*pesëmbëdhjetë*) akte për emërimin gjyqtar të kandidatëve që kishin mbaruar Shkollën e Magjistraturës në vitin akademik 2018-2019 dhe 15 (*pesëmbëdhjetë*) akte për caktimin e tyre në pozicion pranë gjykatave të ndryshme.

5.2 Emërimi i magjistratëve që kanë përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin akademik 2019-2020

⁶⁹ Me vendimin nr. 61, datë 30.01.2020, "Për ushtrimin e rekursit ndaj vendimit nr. 262, datë 23.12.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë".

⁷⁰ Vendimi nr. 1, datë 09.01.2020 që i përket kandidates Erlanda Agaj, Vendimi nr. 2, datë 09.01.2020 që i përket kandidatit Marko Boshku, Vendimi nr. 3, datë 09.01.2020 që i përket kandidates Elisabeta Gjoni, Vendimi nr. 4, datë 09.01.2020 që i përket kandidates Klejda Çapja, Vendimi nr. 5, datë 09.01.2020 që i përket kandidatit Artur Prenga, Vendimi nr. 6, datë 09.01.2020 që i përket kandidatit Mirjan Mustafaj, Vendimi nr. 7, datë 09.01.2020 që i përket kandidates Kostandina Kuro, Vendimi nr. 8, datë 09.01.2020 që i përket kandidates Iva Zemani, Vendimi nr. 9, datë 09.01.2020 që i përket kandidates Enisa Shahini, Vendimi nr. 10, datë 09.01.2020 që i përket kandidates Ema Shaholli, Vendimi nr. 11, datë 09.01.2020 që i përket kandidatit Shkëlzen Liçaj, Vendimi nr. 12, datë 09.01.2020 që i përket kandidatit Xhevdet Lika, Vendimi nr. 13, datë 09.01.2020 që i përket kandidatit Ligoraq Toshi, Vendimi nr. 14, datë 09.01.2020 që i përket kandidatit Hazbi Balliu, Vendimi nr. 15, datë 09.01.2020 që i përket kandidatit Florin Demollari.

⁷¹ Vendimi nr. 42, datë 29.01.2020 që i përket gjyqtares Erlanda Agaj, Vendimi nr. 43, datë 29.01.2020 që i përket gjyqtarit Marko Boshku, Vendimi nr. 44, datë 29.01.2020 që i përket gjyqtares Elisabeta Gjoni, Vendimi nr. 45, datë 29.01.2020 që i përket gjyqtarit Mirjan Mustafaj, Vendimi nr. 46, datë 29.01.2020 që i përket gjyqtares Kostandina Kuro, Vendimi nr. 47, datë 29.01.2020 që i përket gjyqtares Klejda Çapja, Vendimi nr. 48, datë 29.01.2020 që i përket gjyqtares Iva Zemani, Vendimi nr. 49, datë 29.01.2020 që i përket gjyqtares Enisa Shahini, Vendimi nr. 50, datë 29.01.2020 që i përket gjyqtarit Artur Prenga, Vendimi nr. 51, datë 29.01.2020 që i përket gjyqtarit Ligoraq Toshi, Vendimi nr. 52, datë 29.01.2020 që i përket gjyqtarit Hazbi Balliu, Vendimi nr. 53, datë 29.01.2020 që i përket gjyqtares Ema Shaholli, Vendimi nr. 54, datë 29.01.2020 që i përket gjyqtarit Shkëlzen Liçaj, Vendimi nr. 55, datë 29.01.2020 që i përket gjyqtarit Florin Demollari, Vendimi nr. 56, datë 29.01.2020 që i përket gjyqtarit Xhevdet Lika.

Shkolla e Magjistraturës, ka përcjellë pranë Këshillit listën e të diplomuarve për kandidatët gjyqtarë në përfundim të vitit akademik 2019-2020, ku në total ishin 13 (*trembëdhjetë*) kandidatë që kishin përfunduar ciklin 3-vjeçar të studimeve pranë Shkollës së Magjistraturës dhe 6 (*gjashtë*) kandidatë që kishin përfunduar ciklin 2-vjeçar të studimeve pranë Shkollës së Magjistraturës, si subjekte *ex officio*⁷².

Në funksion të verifikimit në kohë të kushteve dhe kriterëve të emërimit për magistratët e diplomuar në Shkollën e Magjistraturës, duke qenë se kjo procedurë është e ndërvarur nga raportimet dhe informacionet e subjekteve publike dhe private që, sipas ligjit, duhet t'i dërgohen Këshillit, me qëllim emërimin e tyre brenda afatit që ligji përcakton, me Vendimin nr.122, datë 05.03.2020, mbështetur në nenin 35 të Ligjit për Statusin, si dhe në Vendimin e tij nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, mbi propozimin e KZHK-së, Këshilli ka vendosur *fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të rekrutimit si gjyqtar të kandidatëve për magistratë, profili gjyqtar, që pritet të diplomohen në vitin akademik 2019-2020*, duke caktuar relatorin për çdo kandidat nga anëtarët e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

Nga ana e relatorëve kanë vijuar procedurat verifikuese sipas përcaktimeve ligjore dhe aktit nënligjor të sipërcituar, por shkak të situatës së krijuar nga përhapja e pandemisë COVID-19, më datë 12.03.2020, Këshilli pezulloi të gjitha afatet dhe procedurat e filluara, duke rifilluar veprimtarinë e tij me Vendimin nr. 142, datë 22.04.2020, “Për rifillimin e veprimtarisë së Këshillit të Lartë Gjyqësor në kushtet e lehtësimit të masave të marra për kufizimin e përhapjes së COVID-19”. Në pikën 4 të këtij vendimi, Këshilli ka vendosur rifillimin e procedurës administrative të verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të rekrutimit si gjyqtar të kandidatëve për magistratë, profili gjyqtar, që pritet të diplomohen në vitin akademik 2019-2020. Për rrjedhojë, më datë 23.04.2020, nga ana e relatorëve vijuan procedurat e verifikimit, duke iu dërguar kandidatëve për magistratë, formularët dhe autorizimet përkatëse (*të përcaktuara në pikën 6, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019*) që duhet të plotësohen dhe dorëzohen nga ana e kandidatëve në kuadër të procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit.

Pas depozitimit të autorizimeve dhe formularëve nga ana e kandidatëve për magistratë, bazuar në pikën 10, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, përmes shkresave të veçanta, është kërkuar informacion dhe raportim nga institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës, përcaktuar në nenin 32 të Ligjit të Statusit, për kandidatët për gjyqtarë të diplomuar në Shkollën e Magjistraturës, ndërsa institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës, kanë përcjellë për Këshillin e Lartë Gjyqësor informacionet dhe raportimet e tyre në kohë të ndryshme.

⁷² Sipas nenit 165 të Ligjit për Statusin.

Nga ana e relatorëve janë verifikuar kushtet e emërimit si gjyqtar sipas nenit 136/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 35, pika 1, shkronja “a” dhe “b” të Ligjit për Statusin, kriteret e përgjithshme dhe të veçanta sipas nenit 28 të Ligjit për Statusin si dhe kriteri i pasurisë dhe figurës, sipas pikës 1, të nenit 32 të Ligjit për Statusin. Në përfundim të procedurave të verifikimit, mbi propozimet e relatorëve anëtarë të KZHK-së, Këshilli ka miratuar vendimet për kualifikimin⁷³ për emërim të të gjithë magistratëve të diplomuar, në total 19 magistratë.

Më pas, me propozim të KZHK-së, mbështetur në nenet 136/a dhe 147/a, pika 1, shkronja “a”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 35, të Ligjit për Statusin, në nenin 61, pika 2, shkronja “a”, nenin 86, shkronja “a” dhe nenin 97, pika 1, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bazuar në vendimet për kualifikimin për emërim të kandidatëve të diplomuar në Shkollën e Magistraturës, Këshilli ka vendosur emërimin gjyqtar të të 19 (*nëntëmbëdhjetë*)⁷⁴ magistratëve.

Pas emërimit gjyqtarë të të sapodiplomuarve nga Shkolla e Magistraturës, mbi propozimet e KZHK-së, me Vendimin e Këshillit nr. 484, datë 20.10.2020⁷⁵, janë shpallur pozicionet e lira për të diplomuarit në përfundim të programit trevjeçar të formimit fillestar në Shkollën e Magistraturës, në vitin akademik 2019-2020 dhe të emëruar gjyqtarë më datë 20.10.2020, ndërsa

⁷³ Vendimi nr. 354, datë 28.09.2020 i përket kandidatës Anjeza Buzo, Vendimi nr. 355, datë 28.09.2020 që i përket kandidatës Miranda Nakaj, Vendimi nr. 356, datë 28.09.2020 që i përket kandidatës Enkel Peza, Vendimi nr. 357, datë 28.09.2020 që i përket kandidatës Arjeta Lika, Vendimi nr. 358, datë 28.09.2020 që i përket kandidatës Arnisa Këlliçi, Vendimi nr. 359, datë 28.09.2020 që i përket kandidatës Marjola Beluli, Vendimi nr. 360, datë 28.09.2020 që i përket kandidatit Aulon Pashaj, Vendimi nr. 361, datë 28.09.2020 që i përket kandidatit Fatmir Ndreu, Vendimi nr. 362, datë 28.09.2020 që i përket kandidatës Alda Sadiku, Vendimi nr. 363, datë 28.09.2020 që i përket kandidatës Jeta Qinami, Vendimi nr. 364, datë 28.09.2020 që i përket kandidatës Maela Alicanaj, Vendimi nr. 365, datë 28.09.2020 që i përket kandidatës Thomaidha Roça, Vendimi nr. 366, datë 28.09.2020 që i përket kandidatit Adrian Shega, Vendimi nr. 367, datë 28.09.2020 që i përket kandidatit Alban Velçani, Vendimi nr. 368, datë 28.09.2020 që i përket kandidatit Gjergji Baçi, Vendimi nr. 369, datë 28.09.2020 që i përket kandidatës Sonila Hoxha, Vendimi nr. 370, datë 28.09.2020 që i përket kandidatës Suela Lika. Vendimi nr. 378, datë 02.10.2020 që i përket kandidatës Entela Gjoni dhe Vendimi nr. 406, datë 09.10.2020 që i përket kandidatit Gentian Jahjollli.

⁷⁴ Vendimi nr. 465, datë 20.10.2020 që i përket kandidatit Alban Velçani, Vendimi nr. 466, datë 20.10.2020 që i përket kandidatit Adrian Shega, Vendimi nr. 467, datë 20.10.2020 që i përket kandidatit Aulon Pashaj, Vendimi nr. 468, datë 20.10.2020 që i përket kandidatit Enkel Peza, Vendimi nr. 469, datë 20.10.2020 që i përket kandidatit Fatmir Ndreu, Vendimi nr. 470, datë 20.10.2020 që i përket kandidatit Gentian Jahjollli, Vendimi nr. 471, datë 20.10.2020 që i përket kandidatit Gjergji Baçi, Vendimi nr. 472, datë 20.10.2020 që i përket kandidatës Alda Sadiku, Vendimi nr. 473, datë 20.10.2020 që i përket kandidatës Anjeza Buzo, Vendimi nr. 474, datë 20.10.2020 që i përket kandidatës Arjeta Lika, Vendimi nr. 475, datë 20.10.2020 që i përket kandidatës Arnisa Këlliçi, Vendimi nr. 476, datë 20.10.2020 që i përket kandidatës Entela Gjoni, Vendimi nr. 477, datë 20.10.2020 që i përket kandidatës Jeta Qinami, Vendimi nr. 478, datë 20.10.2020 që i përket kandidatës Maela Alicanaj, Vendimi nr. 479, datë 20.10.2020 që i përket kandidatës Marjola Beluli, Vendimi nr. 480, datë 20.10.2020 që i përket kandidatës Miranda Nakaj, Vendimi nr. 481, datë 20.10.2020 që i përket kandidatës Sonila Hoxha, Vendimi nr. 482, datë 20.10.2020 që i përket kandidatës Suela Lika, Vendimi nr. 483, datë 20.10.2020 që i përket kandidatës Thomaidha Roça.

⁷⁵ Mbështetur në nenin 147, pika 1 dhe nenin 147/a, pika 1, shkronja “ë”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 39, pika 1, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 25, pika 2, të Ligjit nr. 48/2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në konsideratë të përcaktimeve të nenit 15, pika 4, shkronja “a” dhe të nenit 90, të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, duke mbajtur parasysh numrin e gjyqtarëve të emëruar më datë 20.10.2020 dhe pozicionet e lira në sistemin gjyqësor në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm dhe atij administrative.

me Vendimin e Këshillit nr. 485, datë 20.10.2020⁷⁶, janë shpallur pozicionet e lira për të diplomuarit në përfundim të programit dyvjeçar të trajnimit në Shkollën e Magjistraturës, në vitin akademik 2019-2020 dhe të emëruar gjyqtarë më datë 20.10.2020.

Në përfundim, mbi propozimet e KZHK-së, Këshilli ka proceduar me caktimin në pozicion në gjykatat e shkallës së parë të gjyqtarëve të emëruar, duke miratuar për këtë 19 (nëntëmbëdhjetë)⁷⁷ vendime.

Përfundime në lidhje me procedurat për emërimin e magjistratëve që kanë përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin akademik 2019-2020, nga ku rezulton se janë miratuar:

- **3 (tre) akte administrative kolektive** nga të cilat 1 (një) për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të rekrutimit si gjyqtar, të kandidatëve për magjistratë, profili gjyqtar, dhe 2 (dy) akte administrative kolektive për shpalljen e pozicioneve të lira për të diplomuarit nga Shkolla e Magjistraturës, në vitin akademik 2019-2020;
- **57 (pesëdhjetë e shtatë) akte administrative individuale**, nga të cilat 19 (nëntëmbëdhjetë) vendime për kualifikimin për emërim të kandidatëve të diplomuar, 19 (nëntëmbëdhjetë) vendime për emërimin gjyqtar si dhe 19 (nëntëmbëdhjetë) vendime për caktimin në pozicion të gjyqtarëve të sapo emëruar.

VI. MBI SKEMËN E DELEGIMIT

Në vitin 2020, bazuar në nenin 45⁷⁸ të Ligjit për Statusin, është bërë funksionale skema e delegimit të gjyqtarëve, ku disa gjyqtarë të gjykatave të shkallës së parë, në përmbushje të

⁷⁶ Mbështetur në nenin 147, pika 1 dhe nenin 147/a, pika 1, shkronja “ë”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 39, pika 1, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 25, pika 2, të Ligjit nr. 48/2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në konsideratë të përcaktimeve të nenit 15, pika 4, shkronja “a” dhe të nenit 90, të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, duke mbajtur parasysh numrin e gjyqtarëve të emëruar më datë 20.10.2020 dhe pozicionet e lira në sistemin gjyqësor në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm dhe atij administrative.

⁷⁷ Vendimi nr. 503, datë 27.10.2020 që i përket kandidatës Anjeza Buzo, Vendimi nr. 504, datë 27.10.2020 që i përket kandidatës Alda Sadiku, Vendimi nr. 505, datë 27.10.2020 që i përket kandidatës Thomaidha Roça, Vendimi nr. 506, datë 27.10.2020 që i përket kandidatës Jeta Qinami, Vendimi nr. 507, datë 27.10.2020 që i përket kandidatës Sonila Hoxha, Vendimi nr. 508, datë 27.10.2020 që i përket kandidatit Fatmir Ndreu, Vendimi nr. 509, datë 27.10.2020 që i përket kandidatës Arjeta Lika, Vendimi nr. 510, datë 27.10.2020 që i përket kandidatit Alban Veçani, Vendimi nr. 511, datë 27.10.2020 që i përket kandidatës Entela Gjoni, Vendimi nr. 512, datë 27.10.2020 që i përket kandidatës Suela Lika, Vendimi nr. 513, datë 27.10.2020 që i përket kandidatit Gjergji Baçi, Vendimi nr. 514, datë 27.10.2020 që i përket kandidatës Marjola Beluli, Vendimi nr. 515, datë 27.10.2020 që i përket kandidatit Aulon Pashaj, Vendimi nr. 516, datë 27.10.2020 që i përket kandidatës Arnisa Këlliçi, Vendimi nr. 517, datë 27.10.2020 që i përket kandidatit Adrian Shega, Vendimi nr. 518, datë 27.10.2020 që i përket kandidatit Gentian Jahjollli, Vendimi nr. 519, datë 27.10.2020 që i përket kandidatës Maela Alicanaj, Vendimi nr. 520, datë 27.10.2020 që i përket kandidatit Enkel Peza, Vendimi nr. 521, datë 27.10.2020 që i përket kandidatës Miranda Nakaj.

⁷⁸ Neni 45 i Ligjit për Statusin përcakton se: “1. Magjistratët në të gjitha shkallët, me të paktën një vit përvojë në funksion, mund të kandidojnë për t’u komanduar në një pozicion, në skemën e delegimit, e cila krijohet në Këshill. 2. Magjistrati shërben në skemën e delegimit jo më shumë se 5 vjet. 3. Magjistrati që kandidon për pozicione në skemën e delegimit, nënshkruan një deklaratë për dhënien e pëlqimit për t’u caktuar në çdo gjykatë ose prokurori. 4. Këshilli

përcaktimeve ligjore, me propozimet e KZHK-së, janë komanduar nga Këshilli në skemën e delegimit të ngritur pranë tij. Këta gjyqtarë, më pas, po me propozimet të KZHK-së, janë caktuar nga Këshilli për të gjykuar pranë gjykatave të apelit të juridiksionit të përgjithshëm, për shkak të vakancave të shumta pranë këtyre gjykatave dhe nevojës për të ruajtur funksionalitetin e tyre.

Kështu, në total janë komanduar 9 (nëntë)⁷⁹ gjyqtarë të gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm në skemë delegimi ngritur pranë Këshillit, të cilët më pas janë caktuar për të gjykuar në Gjykatën e Apelit Durrës, në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë, në Gjykatën e Apelit Korçë, në Gjykatën e Apelit Shkodër dhe në Gjykatën e Apelit Vlorë.

Përfundime në lidhje me komandimin e gjyqtarëve në skemën e delegimit të ngritur pranë Këshillit, nga ku rezulton se janë miratuar:

- **10 (dhjetë) akte administrative individuale**, nga të cilat 9 (nëntë) vendime për komandimin e gjyqtarëve në skemën e delegimit dhe 1 (një)⁸⁰ vendim për zgjatjen e afatit të caktimit të gjyqtarës së skemës së delegimit;
- **9 (nëntë) akte administrative individuale** për caktimin e gjyqtarëve të skemës së delegimit në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm.

VII. MBI KOMANDIMIN E GJYQTARËVE

Ligji për Statusin si dhe ligje të tjera⁸¹ parashikojnë mundësinë e shërbimit të gjyqtarëve, për periudha afatgjata, deri në 5 apo edhe 10 vjet, në pozicione të caktuara në institucionet e sistemit të drejtësisë, përmes komandimit të tyre. Parashikimi i institutit të komandimit të gjyqtarëve në institucionet e sistemit të drejtësisë duket që është bërë në funksion të mirëfunksionimit të këtyre institucioneve, duke konsideruar shërbimin e gjyqtarëve në to si një kontribut të rëndësishëm për

cakton magjistratin në skemën e delegimit në bazë të nevojave të një gjykate ose prokurorie: a) në çdo pozicion të të njëjtit nivel ose të një niveli tjetër, për të cilin magjistrati përmbush kërkesat; b) në një pozicion në gjykatën e posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimin të organizuar ose Prokurori të Posaçme, nëse magjistrati përmbush kriteret, sipas nenit 47, të këtij ligji, si dhe jep pëlqimin sipas kërkesës së pikës 3, të nenit 47, të këtij ligji. 5. Në pritje për t'u caktuar pranë një gjykate ose prokurorie, sipas parashikimeve të këtij neni, magjistrati në skemën e delegimit shërben në strukturat administrative të Këshillave. 6. Kryetari i gjykatës ose i prokurorisë ka të drejtë t'i kërkojë Këshillit caktimin për një periudhë të caktuar të magjistratit nga skema e delegimit në gjykatën ose prokurorinë përkatëse, duke paraqitur arsyet e nevojës për caktimin e magjistratit dhe të periudhës kohore të kërkuar. 7. Këshilli vlerëson kërkesën brenda 3 ditëve nga marrja e saj. Nëse Këshilli vlerëson se ka nevojë në gjykatën ose prokurorinë respektive, cakton magjistratin nga skema e delegimit, duke vlerësuar njëkohësisht: a) plotësimin e kërkesave për pozicionin respektiv; b) disponueshmërinë; c) përvojën e veçantë profesionale të magjistratëve; ç) caktimin në mënyrë të barabartë të magjistratëve në skemën e delegimit, në gjykatat apo prokuroritë e largëta. 8. Çdo Këshill miraton rregulla të detajuara për kriteret dhe procedurën për përzgjedhjen e magjistratëve, si dhe kohën e shërbimit për skemën e delegimit”.

⁷⁹ Gjyqtarët Mimoza Margjeka, Arta Duka, Igerta Hysi, Laurent Fuçia, Dritan Hasani, Erjon Çela, Engert Pëllumbi, Florjan Kalaja dhe Sokol Pina.

⁸⁰ Gjyqtare Mimoza Margjeka.

⁸¹ Nenet 53-57 të Ligjit për Statusin, nenet 209 dhe 265 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, nenet 2, pika “dh” dhe 34 të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, neni 14/a, pika 2 të Ligjit nr.8577, datë 10.02.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar.

ushtrimin e funksioneve të tyre. Ndërkohë, për disa nga këto institucione, vetë ligji ka parashikuar, jo vetëm vazhdimësinë e shërbimit të gjyqtarëve në to, por edhe numrin e tyre, sikundër edhe afatin e shërbimit/komandimit.

Përgjatë vitit 2020, mbi propozimet e KZHK-së, Këshilli ka hapur procedurat e komandimit të gjyqtarëve, për shkak të nevojave që paraqiteshin pranë vetë Këshillit, si dhe pranë disa institucioneve të tjera të drejtësisë me kërkesë të këtyre të fundit.

Përfundime në lidhje me gjyqtarët e komanduar përgjatë vitit 2020, nga ku rezulton se janë miratuar:

- **8 (tetë)⁸² akte administrative kolektive** për hapjen dhe/ose rihapjen e procedurave të komandimit të gjyqtarëve në Këshillin e Lartë Gjyqësor, Gjykatën e Lartë, Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe Ministrinë e Drejtësisë;
- **2 (dy)⁸³ akte administrative individuale** në kuadër të procedurës së komandimit si inspektor në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
- **17 (shtatëmbëdhjetë)⁸⁴ akte administrative individuale** që i përkasin procedurave të komandimit si ndihmësmagjistratë të gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë;

⁸² Vendimi nr. 98, datë 26.02.2020 “Për hapjen e procedurës së komandimit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve”; Vendimi nr. 99, datë 26.02.2020 “Për hapjen e procedurës së komandimit në Shkollën e Magjistraturës dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve”; Vendimi nr. 100, datë 26.02.2020 “Për rihapjen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandim në Ministrinë e Drejtësisë, kohëzgjatjen, kushtet, kriteret dhe procedurën e komandimit”; Vendimi nr. 249, datë 09.07.2020 “Për rihapjen e procedurës së komandimit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve”; Vendimi nr. 250, datë 09.07.2020 “Për rishpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandim në Ministrinë e Drejtësisë, kohëzgjatjen, kriteret dhe procedurën e komandimit”; Vendimi nr. 258, datë 23.07.2020 “Për hapjen e procedurës së komandimit në pozicionin e ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve”; Vendimi nr. 322, datë 17.09.2020 “Për rihapjen e procedurës së komandimit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe shpalljen e kërkesave për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve”; Vendimi nr. 400, datë 07.10.2020 “Për shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandim në Këshillin e Lartë Gjyqësor, kohëzgjatjen, kriteret dhe procedurën e komandimit”;

⁸³ Vendimi nr. 69, datë 07.02.2020 “Për komandimin e përkohshëm si inspektor në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, të magjistrates znj. Marsela Pepi”; Vendimi nr. 333, datë 17.09.2020 “Për zgjatjen e afatit të komandimit të përkohshëm si inspektor në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, të magjistrates znj. Marsela Pepi”.

⁸⁴ Vendimi nr. 32, datë 23.01.2020 “Për kërkesës e znj. Hicka për komandim në pozicionin e ndihmësmagjistrates në Gjykatën e Lartë”; Vendimi nr. 33, datë 23.01.2020 “Për konfirmimin si ndihmësmagjistrat në Gjykatën e Lartë të gjyqtarit Engert Pëllumbi dhe zgjatjen e mandatit të komandimit me 1 (një) vit; Vendimi nr. 339, datë 24.09.2020 “Për përfshirjen e kandidates znj. Enisa Shahini, në procedurat e komandimit si ndihmësmagjistrate pranë Gjykatës së Lartë”; Vendimi nr. 340, datë 24.09.2020 “Për përjashtimin e kandidates znj. Erlanda Agaj, nga procedurat e komandimit si ndihmësmagjistrate pranë Gjykatës së Lartë”; Vendimi nr. 341, datë 24.09.2020 “Për përjashtimin e kandidatit z. Sokol Pina, nga procedurat e komandimit si ndihmësmagjistrate pranë Gjykatës së Lartë”; Vendimi nr. 342, datë 24.09.2020 “Për përfshirjen e kandidates znj. Engjëllueshe Tahiri, në procedurat e komandimit si ndihmësmagjistrate pranë Gjykatës së Lartë”; Vendimi nr. 343, datë 24.09.2020 “Për përfshirjen e kandidates znj. Iva Zemani, në procedurat e komandimit si ndihmësmagjistrate pranë Gjykatës së Lartë”; Vendimi nr. 344, datë 24.09.2020 “Për përfshirjen e kandidates znj. Lorena Çabej, në procedurat e komandimit si ndihmësmagjistrate pranë Gjykatës së Lartë”; Vendimi nr. 345, datë 24.09.2020 “Për përjashtimin e kandidatit z. Florin Demollari, në procedurat e komandimit si ndihmësmagjistrat pranë Gjykatës së Lartë”; Vendimi nr. 346, datë 24.09.2020 “Për përjashtimin e kandidatit z. Mirjan Mustafaj, nga procedurat e komandimit si ndihmësmagjistrat pranë Gjykatës së Lartë”; Vendimi nr. 432, datë 14.10.2020 “Për komandimin e znj. Engjëllueshe Tahiri si ndihmësmagjistrate në

- **2 (dy)⁸⁵ akte administrative individuale** që i përkasin procedurës së komandimit të magjistratit si pedagog i brendshëm në Shkollën e Magjistraturës;
- **2 (dy)⁸⁶ akte administrative individuale** që i përkasin procedurave të komandimit të gjyqtarit në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

VIII. MBI TRANSFERIMIN E GJYQTARËVE

8.1 Transferimi i përkohshëm i gjyqtarëve sipas nenit 46 të Ligjit për Statusin

Neni 46 i Ligjit për Statusin përcakton se në rastin kur në skemën e delegimit nuk ka magjistrat të disponueshëm, Këshilli mund t'i kërkojë magjistratit në një nga gjykatat ose prokuroritë me ngarkesën më të ulët, i cili përmbush kriteret për t'u transferuar ose për t'u ngritur në detyrë në pozicionin përkatës, të japë pëlqimin që për një periudhë të caktuar të transferohet përkohësisht në atë pozicion. Ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe më pas edhe Këshilli i Lartë Gjyqësor kanë vendosur transferimin e përkohshëm të disa gjyqtarëve pranë gjykatave që kishin mungesë të gjyqtarëve dhe ku pengohej dhënia e drejtësisë. Në këto raste, në respektim edhe të përcaktimeve ligjore, afati i transferimit ka qenë 1-vit. Në vitin 2020, mbi propozimet e KZHK-së, Këshilli ka vendosur të hapë procedurat e transferimit të përkohshëm për një pozicion të lirë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, për një pozicion të lirë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës dhe për pozicione të lira në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë. Më pas, Këshilli, pas pëlqimit të gjyqtarëve, me propozimet e KZHK-së, ka vendosur të përsërisë transferimin e përkohshëm të 4 (*katër*) gjyqtarëve në 3 (*tre*) gjykata të ndryshme për një periudhë tjetër 1-vjeçare.

Përfundime në lidhje me gjyqtarët e transferuar përkohësisht përgjatë vitit 2020, nga ku rezulton se janë miratuar:

- **3 (tre)⁸⁷ akte administrative kolektive** për hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm në gjykata;

Gjykatën e Lartë”; Vendimi nr. 433, datë 14.10.2020 “Për komandimin e znj. Lorena Çabej si ndihmësmagjistrate në Gjykatën e Lartë”; Vendimi nr. 434, datë 14.10.2020 “Për komandimin e znj. Iva Zemani si ndihmësmagjistrate në Gjykatën e Lartë”; Vendimi nr. 435, datë 14.10.2020 “Për komandimin e znj. Enisa Shahini si ndihmësmagjistrate në Gjykatën e Lartë”; Vendimi nr. 523, datë 27.10.2020 “Për përfundimin e kohëzgjatjes së komandimit si ndihmësmagjistrat pranë Gjykatës së Lartë, të z. Florjan Kalaja”; Vendimi nr. 526, datë 27.10.2020 “Për përfundimin para afatit të kohëzgjatjes së komandimit të gjyqtarit z. Engert Pëllumbi, si ndihmësmagjistrat pranë Gjykatës së Lartë” dhe Vendimi nr. 375, datë 30.09.2020 “Mbi dërgimin e emrave të kandidatëve që plotësojnë kushtet për t'u komanduar në pozicionin e ndihmësmagjistratit pranë Gjykatës së Lartë”.

⁸⁵ Vendimi nr. 159, datë 15.05.2020 “Mbi opinionin për kandidaten znj. Teuta Hoxha në procedurën e komandimit si pedagoge e brendshme, në Departamentin e Formimit Fillestar, të Shkollës së Magjistraturës” dhe Vendimi nr. 165, datë 28.05.2020 “Për përmbushjen nga kandidati të kriterëve dhe kushteve të kandidimit, për t'u komanduar si pedagog i brendshëm, në Departamentin e Formimit Fillestar, të Shkollës së Magjistraturës”.

⁸⁶ Vendimi nr. 37, datë 23.01.2020 “Përrjashtimin nga kandidimi për komandim pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor të gjyqtarës Elona Mihali”; Vendimi nr. 442, datë 14.10.2020 “Për përfshirjen e kandidates znj. Zeta Tërpollari në procedurat e komandimit pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

⁸⁷ Vendimi nr. 193, datë 04.06.2020 “Për hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm për një pozicion të lirë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër”, Vendimi nr. 194, datë 04.06.2020 “Për hapjen e

- **5 (pesë) akte administrative individuale**, prej të cilëve (katër)⁸⁸ akte administrative individuale për përsëritjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtarëve në gjykata të ndryshme dhe 1 (një)⁸⁹ akt administrativ individual për një shtesë në vendimin nr.205, datë 11.06.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

8.2 Transferimi i përkohshëm i gjyqtarëve sipas nenit 44 të Ligjit për Statusin

Sipas nenit 44, pika 1, shkronja “b” të Ligjit për Statusin përcaktohet se: *“Magjistratët transferohen pa pëlqim vetëm në këto raste: ...; b) kur pozicioni i magjistratit suprimohet për shkak të ndryshimeve në strukturën administrative ose në kompetencën tokësore të gjykatave ose prokurorive, pas kryerjes së një vlerësimi, bazuar në kritere objektive dhe transparente; ...”*. Kurse sipas nenit 162, pika 4, të Ligjit për Statusin përcaktohet se: *“Në rast se ndaj gjyqtarit të caktuar përkohësisht, me vendim të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, vendoset masë disiplinore, në bazë të ligjit “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, caktimi i përkohshëm i tij mbaron pavarësisht nëse është bërë ose jo ankimi ndaj këtij vendimi”*.

Përgjatë vitit 2020, KPK-ja ka zhvilluar seancat dëgjimore në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar edhe për gjyqtarët e tjerë pranë gjykatave të posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar që nuk i ishin nënshtruar më parë këtij procesi, duke vendosur në disa raste shkarkimin e tyre nga detyra.

Për gjyqtarët që janë shkarkuar nga KPK-ja, në respektim të parashikimit ligjor, nenit 44, pika 1, shkronja “b” dhe nenit 162, pika 4 të Ligjit për Statusin, mbi propozimin e KZHK-së, Këshilli, ka vendosur deklarinimin e mbarimit të caktimit të përkohshëm të gjyqtarit dhe transferimin e tij në një gjykatë të të njëjtit nivel, si më lart u parashtrua, për të respektuar përcaktimin kushtetues sipas nenit F, pika 5, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Përfundime në lidhje me gjyqtarët në detyrë pranë gjykatave të posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar të cilët janë transferuar sipas nenit 44 të Ligjit për Statusin, nga ku rezulton se janë miratuar:

procedurës së transferimit të përkohshëm për një pozicion të lirë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës”, Vendimi nr. 195, datë 04.06.2020 “Për hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm për pozicione të lira në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë”.

⁸⁸ Vendimi nr. 202, datë 11.06.2020 “Për përsëritjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit Gentian Marku në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër”; Vendimi nr. 203, datë 11.06.2020 “Për përsëritjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtarës Rezarta (Aliu) Paja në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës”; Vendimi nr. 204, datë 11.06.2020 “Për përsëritjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtarës Diamela Goxha në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë”; Vendimi nr. 205, datë 11.06.2020 “Për përsëritjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit Genti Dokollari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë”.

⁸⁹ Vendimi nr. 533, datë 28.10.2020 “Për një shtesë në vendimin nr.205, datë 11.06.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, “Për përsëritjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit Genti Dokollari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë”.

- **3 (tre)⁹⁰ akte administrative individuale** për deklarimin e mbarimit të caktimit të përkohshëm në gjykatën e posaçme respektive për korrupsionin dhe krimin e organizuar dhe transferimin e gjyqtarit në një gjykatë të juridiksionit të përgjithshëm.

IX. MBI MBARIMIN E STATUSIT TË MAGJISTRATIT

Neni 65⁹¹ i Ligjit për Statusin parashikon mundësinë e mbarimit të statusit të gjyqtarit, për shkak të paraqitjes së dorëheqjes pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor. Dorëheqja duhet të jetë me shkrim dhe nuk është e nevojshme të jetë e arsyetuar. Dorëheqja jep efektet në fund të muajit pasardhës, nga dita kur Këshilli merr deklarimin me shkrim të dorëheqjes. Mbarimi i statusit të magjistratit deklarohet me vendim të Këshillit jo më vonë se dy javë nga mbarimi i statusit. Në raste të justifikuara, me kërkesë të motivuar dhe me miratim të Këshillit, dorëheqja mund të japë efekte përpara kohës së përcaktuar në pikën 2 të këtij neni.

Gjatë vitit 2020 janë propozuar nga KZHK 16 (*gjashtëmbëdhjetë*) akte administrative individuale për mbarimin e statusit të gjyqtarëve, të niveleve të ndryshme për shkak të paraqitjes së dorëheqjes para Këshillit të Lartë Gjyqësor. Të gjitha këto propozime janë miratuar nga Këshilli, duke krijuar në këtë mënyrë 16 pozicione të tjera të lira të përhershme në gjykatat shqiptare.

Ndërkohë, nga ana e Komisionit, përpara se të propozohet deklarimi i mbarimit të statusit të gjyqtarit, për një gjyqtar është vendosur revokimi i vendimit nr. 47, datë 29.04.2015, të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë, *“Mbi pezullimin nga detyra të gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, Osman Aliu”*.

Gjithashtu, me propozim të Komisionit, Këshilli me vendimin nr. 451, datë 19.10.2020 ka vendosur përfundimin e procedurës së mbarimit të statusit të magjistratit, për ish-gjyqtarin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, pas administrimit të vendimit nr.10, datë 01.07.2020, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

Përfundime në lidhje me dorëheqjet e paraqitura nga gjyqtarët përgjatë vitit 2020, nga ku rezulton se janë miratuar:

⁹⁰ Vendimi nr. 38, datë 23.01.2020 “Për deklarimin e mbarimit të caktimit të përkohshëm pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe transferimin e gjyqtarës znj. Marsela Balili”; Vendimi nr. 130, datë 30.03.2020 “Për deklarimin e mbarimit të caktimit të përkohshëm dhe transferimin e gjyqtarit Ardit Mustafaj”; Vendimi nr. 230, datë 02.07.2020 “Për deklarimin e mbarimit të caktimit të përkohshëm dhe transferimin e gjyqtarës znj. Nure Dreni”.

⁹¹ Neni 65 i Ligjit për Statusin përcakton se: “1. Magjistrati mund të kërkojë mbarimin e statusit, nëpërmjet paraqitjes së dorëheqjes para Këshillit përkatës. 2. Dorëheqja duhet të jetë me shkrim dhe nuk është e nevojshme të jetë e arsyetuar. Dorëheqja jep efektet në fund të muajit pasardhës, nga dita kur Këshilli merr deklarimin me shkrim të dorëheqjes. Mbarimi i statusit të magjistratit deklarohet me vendim të Këshillit jo më vonë se dy javë nga mbarimi i statusit. 3. Në raste të justifikuara, me kërkesë të motivuar dhe me miratim të Këshillit, dorëheqja mund të japë efekte përpara kohës së përcaktuar në pikën 2 të këtij neni”.

- **16 (gjashtëmbëdhjetë)⁹² akte administrative individuale** për mbarimin e statusit të gjyqtarëve për shkak të paraqitjes së dorëheqjes;
- **1 (një) akt administrativ individual** për revokimin e vendimit të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë për pezullimin nga detyra të gjyqtarit;
- **1 (një) akt administrativ individual** për përfundimin e procedurës së mbarimit të statusit të magjistratit, për ish-gjyqtarin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

X. MBI CAKTIMIN NË POZICION TË GJYQTARËVE

10.1 Caktimi në pozicion i gjyqtarëve të ish-gjykatave për krimet e rënda

Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin nr. 286, datë 18.12.2019 ka vendosur fillimin e funksionimit të Gjykatave të Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar më datë 19.12.2019. Sipas këtij vendimi Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda emërtohet Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ndërsa Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda emërtohet Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Për shkak të fillimit të funksionimit të këtyre gjykatave, duke qenë përpara detyrimit ligjor mbi caktimin e gjyqtarëve në detyrë të Gjykatës së Krimeve të Rënda përkohësisht ose në mënyrë të përhershme, në varësi të përmbushjes së kushteve dhe kritereve ligjore, Këshilli i Lartë Gjyqësor po më datë 18.12.2019, mbi propozimet e KZHK-së, ka miratuar vendimet për caktimin në mënyrë të përhershme ose të përkohshme të gjyqtarëve pranë gjykatave të posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar⁹³.

⁹² Vendimi nr. 17, datë 09.01.2020 "Për mbarimin e statusit të magjistratit për gjyqtarin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, z. Osman Aliu"; Vendimi nr. 18, datë 09.01.2020 "Për mbarimin e statusit të magjistratit për gjyqtaren e Gjykatës së Apelit Shkodër, znj. Marina Rraboshta"; Vendimi nr. 19, datë 09.01.2020 "Për mbarimin e statusit të magjistratit për gjyqtarin e Gjykatës së Apelit Korçë, z. Stavri Kallço"; Vendimi nr. 34, datë 23.01.2020 "Për mbarimin e statusit të magjistratit për gjyqtaren e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, znj. Arjana Liço"; Vendimi nr. 35, datë 23.01.2020 "Për mbarimin e statusit të magjistratit për z. Ndue Gjura, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, i komanduar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor"; Vendimi nr. 36, datë 23.01.2020 "Për mbarimin e statusit të magjistratit për gjyqtarin e Gjykatës së Apelit Durrës, z. Petraq Dhimitri"; Vendimi nr. 158, datë 15.05.2020 "Për mbarimin e statusit të magjistratit për gjyqtarin e Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, z. Amarildo Laçi"; Vendimi nr. 239, datë 07.07.2020 "Për mbarimin e statusit të magjistratit për gjyqtaren e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, znj. Regleta Panajoti"; Vendimi nr. 248, datë 09.07.2020 "Për mbarimin e statusit të magjistratit për gjyqtaren e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, znj. Rezarta Mataj"; Vendimi nr. 264, datë 30.07.2020 "Për mbarimin e statusit të magjistratit për gjyqtarin e Gjykatës së Apelit Tiranë, z. Gjin Gjoni"; Vendimi nr. 265, datë 30.07.2020 "Për mbarimin e statusit të magjistratit për gjyqtarin e Gjykatës së Apelit Tiranë, z. Alaudin Malaj"; Vendimi nr. 292, datë 08.09.2020 "Për mbarimin e statusit të magjistratit për gjyqtarinë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, z. Zihni Shahu"; Vendimi nr. 348, datë 24.09.2020 "Për mbarimin e statusit të magjistratit për gjyqtaren e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, znj. Enkeleda Doda"; Vendimi nr. 425, datë 12.10.2020 "Për mbarimin e statusit të magjistratit për z. Fatbardh Çoniku, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, i komanduar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor"; Vendimi nr. 532, datë 28.10.2020 "Për mbarimin e statusit të magjistratit z. Fran Prendi, gjyqtar pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar".

⁹³ Referuar për këtë përcaktim të nenit 162, pikat 1, 3 dhe 4, të Ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar që parashikon se: "1. Gjyqtari në detyrë në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda ose Gjykatën e Apelit për Krimeve të Rënda qëndron në pozicionin e tij deri në momentin e krijimit të gjykatave të posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimin të organizuar, me

Caktimi i përkohshëm i disa gjyqtarëve u bë në kushtet e parashikuara nga neni 162, pika 3, e Ligjit për Statusin pasi rezultoi se ndaj këtyre gjyqtarëve kishte filluar procesi i rivlerësimit, sipas përcaktimeve të Ligjit “Për rivlerësimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, mirëpo në datën 18.12.2019 ende nuk kishte një vendim të formës së prerë për konfirmimin e tyre në detyrë, ndërkohë që gjyqtari dhe familjarët e tij kishin dhënë pëlqimin për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”.

Përgjatë vitit 2020, KPK-ja ka zhvilluar seancat dëgjimore në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar edhe për gjyqtarët e tjerë pranë gjykatave të posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar që nuk i ishin nënshtruar më parë këtij procesi, duke vendosur në disa raste konfirmimin në detyrë të gjyqtarëve, ndërsa disa në raste të tjera shkarkimin e tyre nga detyra, sikurse më sipër është cituar.

Për gjyqtarët që janë konfirmuar në detyrë me vendim përfundimtar, Këshilli, me propozim të KZHK, ka miratuar vendimet për caktimin e tyre në mënyrë të përhershme pranë gjykatave të posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar.

Përfundime në lidhje me gjyqtarët në detyrë pranë gjykatave të posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar, nga ku rezulton se janë miratuar:

- **5 (pesë)⁹⁴ akte administrative individuale** për caktimin në pozicion, në mënyrë të përhershme, të gjyqtarit në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

përrjashtim të rasteve kur ka shkaqe për mbarimin e statusit të magjistratit, ose si rezultat i procesit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë". ... 3. Nëse ndaj gjyqtarit në detyrë të Gjykatës së Krimeve të Rënda ka filluar procesi i rivlerësimit në shkallë të parë nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, me vendim të formës së prerë, dy javë pas krijimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshilli i Lartë Gjyqësor cakton gjyqtarin përkohësisht në nivelin përkatës në gjykatën e posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimin të organizuar, me kusht që ai, si dhe familjarët e afërm të tij të japin pëlqimin për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas ligjit "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar". 4. Në rast se ndaj gjyqtarit të caktuar përkohësisht, me vendim të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, vendoset masë disiplinore, në bazë të ligjit "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", caktimi i përkohshëm i tij mbaron pavarësisht nëse është bërë ose jo ankim ndaj këtij vendimi".

⁹⁴ Vendimi nr. 39, datë 23.01.2020 “Për caktimin në pozicion, në mënyrë të përhershme, në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar të gjyqtares znj. Daniela Shirka”; Vendimi nr. 121, datë 05.03.2020 “Për caktimin në pozicion në mënyrë të përhershme, në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, të gjyqtares znj. Iliriana Olldash”; Vendimi nr. 136, datë 16.04.2020 “Për caktimin në pozicion, në mënyrë të përhershme, në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar të gjyqtares znj. Miliana Muça”; Vendimi nr. 137, datë 16.04.2020 “Për caktimin në pozicion, në mënyrë të përhershme, në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar të gjyqtarit z. Klodian Kurushi”; Vendimi nr. 297, datë 10.09.2020 “Për caktimin në pozicion, në mënyrë të përhershme, në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar të gjyqtarit z. Sandër Simoni”.

10.2 Caktimi në pozicion i gjyqtarëve që gëzonin të drejtën e kthimit ose të caktimit në pozicion në nivel apeli

Sipas nenit 57, pika 4, të Ligjit për Statusin, gjyqtari i komanduar gëzon të drejtën e kthimit në pozicionin e mëparshëm. Mbi këtë bazë, në një rast, pas përfundimit të periudhës së komandimit, mbi propozimin e Komisionit, mbasi ka vendosur për refuzimin e kërkesës së magjistratit për t'u komanduar përsëri⁹⁵, në respektim të të drejtës së kthimit në pozicionin e mëparshëm dhe në kushtet e pamundësisë së kthimit në këtë pozicion⁹⁶, Këshilli ka vendosur caktimin e tij një pozicion tjetër të të njëjtit nivel, përmes transferimit⁹⁷.

Sipas nenit 62, pika 1 të Ligjit për Statusin, gjyqtari i Gjykatës së Lartë, në përfundim të mandatit, gëzon të drejtën e caktimit në një pozicion në nivel apeli. Mbi këtë bazë, pas konstatimit të përfundimit të detyrimit të qëndrimit në detyrë në pritje të emërimit të pasardhësit, me propozim të Komisionit, Këshilli ka miratuar Vendimin nr. 260, datë 23.07.2020, "Për publikimin e pozicioneve të lira në nivel apeli, për gjyqtarin Ardian Dvorani që ka të drejtën e caktimit në një pozicion të tillë". Pas ushtrimit të së drejtës së zgjedhjes nga ana e gjyqtarit, me propozim të Komisionit, Këshilli ka miratuar Vendimin nr. 266, datë 30.07.2020, për caktimin e gjyqtarit në Gjykatën Administrative të Apelit.

XI. MBI CAKTIMIN E GJYQTARËVE NË ÇËSHTJE TË VEÇANTA

Sikurse është parashtruar edhe më sipër, nisur nga volumi i madh i kërkesave të ardhura pranë KLGJ-së, nga gjykatat e shkallës së parë dhe të dytë, të cilat kërkonin caktim gjyqtarësh për plotësimin e trupave gjyqësore, Komisioni në vitin 2019 hartoi dhe i propozoi KLGJ-së projektvendimin "Për rregullat dhe procedurat për caktimin e gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme", miratuar me Vendimin e Këshillit nr. 30, datë 14.02.2019 (*i ndryshuar*).

Me Vendimin e Këshillit nr. 125, datë 06.03.2020 "Mbi gjyqtarët e caktuar në çështje gjyqësore të veçanta në ish-gjykatat për krimet e rënda, sot gjykatat e posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar", mbi propozimin e KZHK-së, Këshilli i dha zgjidhje situatës problematike në gjykatat e posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar sa i përkiste gjykimit të 9 (nëntë) çështjeve gjyqësore që kishin qenë për shqyrtim përpara gjykatave për krimet e rënda, të cilat për shkak të ligjit, u transferuan për gjykim përpara gjykatave të posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar.

⁹⁵ Me Vendimin nr.32/1, datë 23.01.2020, Këshilli ka vendosur: "Të refuzojë kërkesën e magjistrates Alma Hicka për dhënie pëlqimi për komandimin e saj si ndihmësmagjistrate në Gjykatën e Lartë".

⁹⁶ Me Vendimin nr.32/1, datë 23.01.2020, Këshilli ka vendosur: "Të njohë të drejtën e znj. Hicka për të zgjedhur në një nga gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm të shkallës së parë që kanë një pozicion të lirë të përhershëm".

⁹⁷ Me Vendimin nr.67, datë 06.02.2020, Këshilli ka vendosur: "1. Transferimin e gjyqtares znj. Alma Hicka pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. ...".

Ndërkohë, për shkak të nevojave që paraqiste Gjykata e Apelit Korçë, ndërsa ajo doli jashtë funksionit për shkak të mungesës së numrit minimal të gjyqtarëve në detyrë, Këshilli, me propozim të Komisionit, ka miratuar Vendimin nr.26⁹⁸, datë 16.01.2020, “Për zbatimin e vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.30, datë 14.02.2019, “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, në lidhje me nevojat e Gjykatës së Apelit Korçë”. Në të njëjtën mbledhje, po me propozim të KZHK-së, Këshilli ka miratuar edhe Vendimin nr. 27, datë 16.01.2020, për miratimin e listës së gjyqtarëve të gjykatave të apelit, që caktohen për të gjykuar, në Gjykatën e Apelit Korçë.

Gjithashtu, për shkak se edhe një tjetër gjykatë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbinit doli jashtë funksioni për shkak të diagnostikimit të të gjithë gjyqtarëve me Covid-19, me propozim të Komisionit, Këshilli ka miratuar Vendimin nr. 311, datë 11.09.2020, “Për zbatimin e vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.30, datë 14.02.2019 “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, në lidhje me nevojat e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbinit”. Pas miratimit të këtij vendimi, po me propozim të KZHK-së, me Vendimin nr. 312, datë 11.09.2020, Këshilli ka miratuar listën e gjyqtarëve që do të caktohen për të gjykuar çështje gjyqësore urgjente në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbinit.

Ndërkohë, gjatë vitit 2020 janë depozituar në Këshillin e Lartë Gjyqësor **629** (gjashtëqind e njëzetë e nëntë) kërkesa për caktim gjyqtari nga kryetarët respektivë të gjykatave me motivacionin se janë në pamundësi për shqyrtimin e tyre, nga të cilat:

- 216 kërkesa të ardhura nga gjykatat e rretheve gjyqësore (përfshirë gjykatën e posaçme të shkallës së parë);
- 14 kërkesa të ardhura nga gjykatat administrative;
- 394 kërkesa të ardhura nga gjykatat e apeleve; si dhe
- 5 kërkesa të ardhura nga Gjykata e Lartë.

Në përgjigje të këtyre kërkesave, mbi propozimet e KZHK-së dhe pas procedurave të shortit elektronik, janë caktuar **874** (tetëqind e shtatëdhjetë e katër) gjyqtarë për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të ndryshme, nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme, nga të cilët:

- 277 gjyqtarë nga gjykatat e rretheve gjyqësore (përfshirë gjykata e posaçme e shkallës së parë);
- 7 nga gjykatat administrative të shkallës së parë dhe
- 590 nga gjykatat e apeleve juridiksion i përgjithshëm dhe posaçëm.

Në lidhje me caktimin e gjyqtarëve në çështje të veçanta ka pasur kërkesa nga gjyqtarë edhe për përjashtimin e tyre nga lista e gjyqtarëve që caktohen për gjykimin e çështjeve gjyqësore të

⁹⁸ Me Vendimin nr. 79, datë 24.02.2020 “Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 26, datë 16.01.2020”, në Vendimin nr. 26, datë 16.01.2020 u bë një ndryshim mbi një vendim.

veçanta, në gjykata të tjera, të ndryshme nga ato ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme. Në lidhje me këto kërkesa, mbi propozime të KZHK, Këshilli ka disponuar me 3 (tre)⁹⁹ vendime, ku në dy raste ka vendosur pranimin e kërkesës së gjyqtarit për t'u përjashtuar nga lista e gjyqtarëve që caktohen për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta dhe në një rast ka vendosur mospranimin e kërkesës së gjyqtarit.

XII. MBI ÇËSHTJE TË TJERA

Përveç sa sipër, KZHK ka trajtuar si dhe ka kaluar për shqyrtim në Këshill edhe disa çështje të tjera që lidhen me fushën e veprimtarisë së tij, mbi të cilin Këshilli ka miratuar 5 (pesë)¹⁰⁰ vendimmarrje.

Gjithashtu, nga ana e KZHK janë trajtuar edhe një sërë kërkesash të gjyqtarëve dhe institucioneve të ndryshme lidhur me çështje të cilat përfshihen në veprimtarinë e KZHK, për të cilat është hartuar kthim përgjigje apo adresuar për zgjidhje problematika e bërë prezent.

XIII. PËRFUNDIME

Gjatë vitit 2020, mbi projektvendime të propozuara nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka miratuar gjithsej 508 vendime, nga të cilat:

- **4 vendime për miratimin apo ndryshimin e akteve nënligjore;**
- **16 vendime në kuadër të procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur;**
- **203 vendime në kuadër të procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, në gjykatat e posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar, në gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm dhe në Gjykatën Administrative të Apelit (67 vendimmarrje në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, 57 vendimmarrje në**

⁹⁹ Vendimi nr. 231, datë 02.07.2020 "Për mospranimin e kërkesës së gjyqtarës Yrfet Shkrelit për përjashtimin e saj nga lista e gjyqtarëve që caktohen për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta, në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme", Vendimi nr. 347, datë 24.09.2020 "Për përjashtimin e gjyqtarës Merita Karaj nga lista e gjyqtarëve që caktohen për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme" dhe Vendimi nr. 573, datë 20.11.2020 "Për përjashtimin e gjyqtarës Ersida Bajgora nga lista e gjyqtarëve që caktohen për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta, në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme".

¹⁰⁰ Vendimi nr. 61, datë 30.01.2020 "Për ushtrimin e rekursit ndaj vendimit nr.262 datë 23.12.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë", Vendimi nr. 160, datë 15.05.2020 "Mbi statusin e këshilltarit/ndihmësit ligjor jomagjistrit në Gjykatën e Lartë, të znj.Aulona Bodo", Vendimi nr. 259, datë 23.07.2020 "Për pezullimin e shqyrtimit të kërkesës për rikthimin në detyrë të znj. Ariana Çaçi", Vendimi nr. 587, datë 20.11.2020 "Për ushtrimin e të drejtës së rekursit kundër vendimit nr.93, datë 10.11.2020, të Gjykatës Administrative të Apelit" dhe Vendimi nr. 140, datë 16.04.2020 "Për trajtimin dhe përgatitjen për shqyrtim të çështjes në lidhje me problematikën e adresuar nga Presidenti i Republikës sa i përket vijimit të ushtrimit të detyrës nga anëtari i Gjykatës së Lartë, z. Ardian Dvorani".

procedurat e ngritjes në detyrë në gjykatat e posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar dhe 79 vendimmarrje në procedurat e ngritjes në detyrë në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe Gjykatën Administrative të Apelit);

- **91 vendime në kuadër të procedurave të emërimit të magjistratëve** (31 vendimmarrje në procedurat e emërimit të magjistratëve që kanë përfunduar Shkollën e Magjistraturës, në vitin akademik 2018-2019 dhe 60 vendimmarrje në procedurat e emërimit të magjistratëve që kanë përfunduar Shkollën e Magjistraturës, në vitin akademik 2019-2020);
- **3 vendime në kuadër të procedurës së përcaktimit të numrit të kandidatëve për gjyqtarë, për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë që do të pranohen në programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2020-2021;**
- **18 vendime në kuadër të procedurave të mbarimit të statusit të magjistratit;**
- **31 vendime në kuadër të procedurave të komandimit të gjyqtarëve;**
- **19 vendime në kuadër të procedurave të skemës së delegimit të ngritur pranë Këshillit sipas nenit 45 të Ligjit për Statusin;**
- **11 vendime në kuadër të procedurave të transferimit të përkohshëm të gjyqtarëve** (8 vendime sipas nenit 46 të Ligjit për Statusin dhe 3 vendime sipas nenit 44 të Ligjit për Statusin);
- **8 vendime në kuadër të procedurave të caktimit në pozicion të gjyqtarëve** (5 vendime për caktimin në pozicion në mënyrë të përhershme të gjyqtarëve të gjykatave të posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar, 1 vendim për caktimin në pozicion të gjyqtarit që gëzonte të drejtën e kthimit në pozicionin e mëparshëm dhe 2 vendime për caktimin në pozicion të gjyqtarit që gëzonte të drejtën e të caktimit në pozicion në nivel apeli);
- **40 vendime në kuadër të procedurave të verifikimit të kushteve dhe kritereve të kandidimit për në formimin fillestar, profili gjyqtar, për në Shkollën e Magjistraturës** (2 vendime në lidhje me kandidatët e shpallur fitues për vitin akademik 2019-2020, 37 vendime në lidhje me kandidatët e shpallur fitues për vitin akademik 2020-2021 dhe 1 vendim në lidhje me fillimin e procedurës së verifikimit);
- **59 vendime në kuadër të procedurave të caktimit të gjyqtarëve në çështje gjyqësore të veçanta, në gjykata të tjera të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme, nga të cilat 50 vendime nëpërmjet të cilave janë trajtuar 629 (gjashtëqind e njëzetë e nëntë) kërkesa për caktim gjyqtari dhe në përgjigje të tyre janë caktuar 874 (tetëqind e shtatëdhjetë e katër) gjyqtarë për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të ndryshme, nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme, si dhe 9 vendime për çështje të tjera në kuadër të caktimit të gjyqtarëve në çështje të veçanta.**
- **5 vendime në kuadër të procedurave të tjera të lidhura me statusin dhe karrierën gjyqësore.**

XIV. OBJEKTIVAT PËR VITIN 2021

1. Miratimi i akteve nënligjore

- Bazuar, në pikën 12, të nenit 52 të Ligjit për Statusin, KZHK do të duhet të hartojë dhe propozojë rregulla më të detajuara, që lidhen me ngritjen në detyrën e kryetarit të gjykatës (me përjashtim të Kryetarit të Gjykatës së Lartë).

2. Përfundimi i procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur dhe radhët e gjyqtarëve të iniciuara në vitin 2019-2020, si dhe hapja e procedurave të tjera të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, për tre pozicionet e fundit të lira, përgjatë vitit 2021

- Përfundimi i procedurës së vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatit për në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin nr. 172, datë 11.09.2019.
- Përfundimi i procedurave të renditjes së kandidatëve për secilin nga 11 pozicionet e lira, në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve jo më vonë se 20 ditë, nga momenti i përfundimit të vlerësimeve etike dhe profesionale të gjithë kandidatëve për çdo pozicion të lirë.
- Hapja e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, për tre pozicionet e fundit të lira (nga një pozicion në secilën fushë të së drejtës).

3. Përfundimi i procedurave të ngritjes në detyrë në gjykatat e posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar, gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm dhe Gjykatën Administrative të Apelit dhe hapja dhe/ose rihapja e procedurave të ngritjes në detyrë pranë këtyre gjykatave

- Përfundimi i procedurave të renditjes së kandidatëve për secilin nga pozicionet e lira në gjykatat e posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar, gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe Gjykatën Administrative të Apelit, jo më vonë se 20 ditë, nga momenti i përfundimit të vlerësimeve etike dhe profesionale të gjithë kandidatëve për çdo pozicion të lirë.
- Hapja dhe/ose rihapja e procedurave të ngritjes në detyrë pranë gjykatave të posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar, gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm dhe Gjykatën Administrative të Apelit.

4. Bashkëpunimi me Shkollën e Magjistraturës për caktimin e kuotave për magjistratë dhe për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë për vitin akademik 2021-2022

- Në respektim të detyrimeve të përcaktuara në pikën 1, të nenit 29, të Ligjit për Statusin në janar të çdo viti, Këshilli duhet të përcaktojë dhe publikojë numrin maksimal të kandidatëve magjistratë (profili gjyqtar) që pranohen në formimin fillestar për vitin e ri akademik. Krahas kësaj, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në pikën 2, të nenit 53, të Ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, Këshilli duhet të përcaktojë dhe publikojë edhe numrin maksimal të

kandidatëve këshilltarë dhe ndihmës ligjorë, që pranohen në formimin fillestar për vitin e ri akademik.

5. Bashkëpunimi me Shkollën e Magjistraturës për verifikimin me prioritet të kandidaturave, të cilat mund të pranohen në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës për vitin 2021-2022

- Referuar përcaktimit ligjor, të bërë në pikën 5, neni 262 të Ligjit 115/2016, që parashikon se: *“Viti akademik hapet të hënën e parë të muajit tetor dhe mbaron jo më vonë se fundi i korrikut të vitit pasardhës”*, Këshilli në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës do të duhet të fillojë në kohë dhe të verifikojë me prioritet kandidatët, të cilët mund të pranohen në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës për vitin 2021-2022, me qëllim që të hënën e parë të tetorit 2021 të gjithë kandidatët fitues të kualifikuar të fillojnë procesin mësimor rregullisht.

6. Trajtimin në kohë të kërkesave të ardhura nga gjykatat ku do të kërkohet delegimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve të caktuara, në kushtet kur nëpër gjykata vijon krijimi i vakancave për efekt të procesit të rivlerësimit kalimtar ndaj gjyqtarëve.

7. Trajtimin në kohë të kërkesave të ardhura nga gjyqtarët apo gjykatat e ndryshme që lidhen me çështje të karrierës gjyqësore.